



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 18/2022 regjistër (JR)

Datë 12.04.2022

Nr. 23 i vendimit

Datë 18.03.2025

V E N D I M
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Sokol Çomo	Kryesues
Rezarta Schuetz	Relatore
Albana Shtylla	Anëtare
Ina Rama	Anëtare
Mimoza Tasi	Anëtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, në dhomë këshillimi, më datë 18.03.2025, ditën e martë, në orën 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Ferdinando Buatier de Mongeot, me Sekretare Gjyqësore Jerina Gjika, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Erind Reovica, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 508, datë 10.02.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Erind Reovica.

BAZA LIGJORE: Nenet 42 dhe 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë; neni F i Aneksit të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, nenet 1, 2, 62, 63 dhe 66, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve ne Republikën e Shqipërisë”; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; neni 46 e vijues i ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore, në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016), shqyrtoi pretendimet dhe kërkimet e subjektit të rivlerësimit të paraqitura në ankim, dhe parashtrimet shtesë të depozituara në Kolegjin e Posaçëm të Apelit (në vijim Kolegji), sipas të cilave, ai kërkoi përfundimisht prishjen ose ndryshimin e vendimit nr. 508, datë 10.02.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe konfirmimin në detyrë, dëgjoi gjyqtaren relatores, Rezarta Schuetz, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Në lidhje me rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Erind Reovica (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio* në zbatim të nenit 179/b, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe nenit 3, pika 16, të ligjit nr. 84/2016, për shkak të ushtrimit të funksionit të prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier. Komisioni i Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), ka administruar raportet e hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim, “ILDKPKI”), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim, “DSIK”) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim, “KLP”).

1.1. ILDKPKI-ja, në përfundim të procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, dërgoi pranë Komisionit një raport të hollësishëm, sipas të cilit: (i) deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin; (ii) ka mungesë dokumentacioni ligjor për justifikimin e pasurive; (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; (iv) nuk ka kryer deklarim të rremë; (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

1.2. DSIK-ja, në përfundim të procesit të kontrollit të figurës të subjektit të rivlerësimit ka përcjellë raportin e vlerësimit të përditësuar, duke konstatuar *papërshtatshmëri* për vazhdimin e detyrës për subjektin e rivlerësimit.

1.3. KLP-ja, ka dërguar Raportin për vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, bazuar në: (i) formularin e vetëdeklarimit; (ii) tri dokumentet ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, të dhënat e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit; (iii) pesë dosjet penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; si dhe (iv) të dhënat nga burimet arkivore të KLP-së, të Prokurorisë së Përgjithshme dhe prokurorive të rretheve.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

2. Pasi kreu hetimin për të tria kriteret e rivlerësimit, nëpërmjet vendimit objekt shqyrtimi me nr. 508, datë 10.02.2022, Komisioni konkludoi me masën disiplinore të *shkarkimit nga detyra*. Arsyeimi i Komisionit u bazua në përfundimet e arritura për kriterin e pasurisë, atë të vlerësimit

profesional, si edhe në vlerësimin tërësor të rrethanave, në zbatim të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016¹. Përfundimisht, Komisioni ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit:

2.1. *Nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e kriterit të kontrollit të pasurisë, pasi ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për këtë kriter, sipas parashikimit të nenit 61, pika 3, të ligjit nr. 84/2016, i cili i referohet parashikimeve të nenit 33 të këtij ligji.*

2.2. Rezulton “i papërshtatshëm” në lidhje me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, sipas parashikimit të nenit 61, pika 4 të ligjit nr. 84/2016. Ai ka treguar cilësi të papranueshme në punë, hetim të dobët, si dhe nuk ka respektuar normalisht të drejtat e pjesëmarrësve në proceset penale të verifikuara, kryesisht për shkak të zgjatjes në mënyrë të përsëritur dhe të pajustificuar të hetimeve. Mungesa e bashkëpunimit me Komisionin në procesin e rivlerësimit të aftësive profesionale, u mbajt në konsideratë në favor të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, sipas parashikimit të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016. Qëndrimi i subjektit në lidhje me çdo konstatim të Komisionit, justifikimet në lidhje me mungesën e përgjigjeve dhe mosvënien në dispozicion të dokumentacionit për dosjet penale të kërkuara, u konsideruan si veprime që cenojnë besimin e publikut.

2.3. Në vlerësimin tërësor të rrethanave, në kuptim të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, me veprimet dhe mosveprimet e tij, ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë, sipas parashikimit të nenit 61, pika 5 të ligjit nr. 84/2016.

III. Shkaqet e ankimit të ngritur nga subjekti i rivlerësimit

3. Subjekti i rivlerësimit ka ushtruar ankim² kundër vendimit të Komisionit. Bashkë me ankimin, subjekti i rivlerësimit ka depozituar pesë (5) akte³, duke kërkuar administrimin e tyre në cilësinë e provës. Me pretendimin se procesi i rivlerësimit është kryer në shkelje të rënda procedurale, të cilat i kanë cenuar rëndë të drejtën kushtetuese dhe konventore për një proces të rregullt ligjor, dhe se vendimi i ankimit është bazuar në konstatim të gabuar e të paplotë të gjendjes faktike, subjekti i rivlerësimit, bazuar në nenet 49 dhe 51, germa “c”, të ligjit nr. 49/2012, i kërkon Kolegjit të shqyrtojë ankimin në seancë gjyqësore publike, qoftë për vlerësimin e drejtë të provave si dhe për t’i dhënë atij mundësi të dëgjohet nga një Gjykatë, si një garanci e respektimit të procesit të rregullt ligjor, të mbrojtur nga neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 6 i KEDNJ-së. Në kërkimet përfundimtare, subjekti i rivlerësimit shprehet se ka arritur nivel të besueshëm në të

¹Në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës, Komisioni, bazuar në të dhënat që disponon, nuk mund të vlerësojë se subjekti është i papërshtatshëm për vijimin e ushtrimit të detyrës. Ndonëse për disa persona janë evidentuar procedime penale për vepra të përfshirjes në krimin e organizuar, kontakti i subjektit me ta mbetet në nivel dyshimesh, duke mos arritur dot në konkluzionin që subjekti ka kontakte të papërshtatshme, në kuptim të pikës 6, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016. Gjithashtu, nuk u evidentuan të dhëna për përfshirje të subjektit në veprimtari korruptive.

²Regjistruar në Komision me nr. {***} prot, datë 02.04.2022.

³Shkresën e Komisionit datë 16.03.2022, për njoftimin e vendimit nr. 508 datë 10.02.2022; dy vendime të Prokurorisë së rrethit gjyqësor Lushnjë për mosfillim procedimi penal, njëri i datës 14.04.2021 ndaj S. F., dhe tjetri me datë 19.12.2017 ndaj S. K.; akte të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier, respektivisht, kërkesë datë 20.06.2020 për dërgimin në gjykim të çështjes penale me të pandehur R. F., bashkë me diskutimin përfundimtar për këtë çështje penale dhe procesverbalin e datës 12.06.2018 për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale, A. K.

tria kriteret e vlerësimit, e në këto kushte, i kërkon Kolegjit të vendosë prishjen ose ndryshimin e vendimit të Komisionit dhe konfirmimin e tij në detyrën e prokurorit.

3.1. Në datën 12.03.2025, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në Kolegj parashtrime shtesë, në bazë të nenit 62 e vijues të ligjit nr. 84/2016 dhe nenit 460, pika 5, të Kodit të Procedurës Civile. Subjekti nuk ka depozituar akte, ndërsa risjell në mënyrë të përmbledhur pretendimet e ngritura në ankim, por tashmë vetëm në lidhje me kriterin e pasurisë. Në këto parashtrime shtesë, subjekti i rivlerësimit, duke iu referuar vendimit të GjEDNj-së, datë 13.12.2022, “Sevdari kundër Shqipërisë”, i cili duhet të gjejë zbatim edhe në rastin e tij për shkak të ngjashmërisë, i kërkon Kolegjit t’i vlerësojë pasuritë dhe të ardhurat nga puna në emigracion, të krijuara përpara fillimit të detyrës si prokuror, nën dritën e parimit të proporcionalitetit.

3.2. Në vijim të këtij arsytimi, prezantohen në mënyrë të përmbledhur shkaqet e ngritura në ankim dhe në parashtrimet e depozituara në Kolegj, të grupuara në shkaqe me natyrë procedurale, që lidhen me procesin e rregullt ligjor, dhe në shkaqe që lidhen me themelin e çështjes e konkretisht, kundërshtime lidhur me vlerësimin e kriterit të pasurisë, kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, dhe vlerësimin e cenimit të besimit të publikut.

III/1. Shkaqet e ankimit me natyrë procedurale

4. Subjekti pretendon se vendimi i marrë ndaj tij ka qenë i paragjykuar, i paracaktuar, dhe është bazuar në një hetim të paplotë. Ai proces është zhvilluar në shkelje të parimeve themelore procedurale që garantojnë të drejtën konventore dhe kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, sikurse janë: parimi i gjykimit nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e drejta për tu mbrojtur e dëgjuar në mënyrë efektive dhe drejtësisht, parimi i barazisë së palëve dhe i kontradiktoritetit, si edhe parimi i proporcionalitetit.

4.1. Konkretisht, trupi gjykues që ka kryer procesin e rivlerësimit të subjektit, nuk përmbushte kriteret e një gjykate të pavarur dhe të paanshme, arsyetuar nga GjEDNj-ja, në çështjen “Volkov kundër Ukrainës”. Ai (trupi gjykues) nuk mund të konsiderohet si një “gjykatë e krijuar me ligj”, për shkak se disa anëtarë të trupës nuk përmbushnin kërkesat e ligjit nr. 84/2016 për të qenë anëtarë të Komisionit dhe procedura e emërimit të tyre është bërë në shkelje të legjislacionit të brendshëm. Ankuesi, praktikisht nuk ka asnjë mundësi për të kundërshtuar përbërjen e Komisionit, për sa kohë Kolegji në jurisprudencën e krijuar deri në momentin e ankimit, ka konfirmuar mungesën e kompetencës për të shqyrtuar pretendimet e subjekteve për përmbushjen ose jo, të kushteve të zgjedhshmërisë të anëtarëve të organeve të rivlerësimit.

4.2. Dyshimi objektiv mbi paanshmërinë e trupit gjykues është krijuar edhe për shkak të dublimit të funksioneve të anëtarëve të trupit gjykues, të cilët kryen njëkohësisht hetimin, vlerësimin dhe vendimarrjen.

4.3. E drejta për t’u gjykuar nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, është cenuar edhe për faktin se ndaj subjektit është zhvilluar një proces i paragjykuar dhe i paravendosur, ndonëse arsytet për këtë qëndrim të njëanshëm, vijnë në mbetën të paqarta për të.

III/2. Shkaqet e ankimit lidhur me vlerësimin e pasurisë

5. Subjekti i rivlerësimit e kalon testin e standardit kushtetues të të provuarit bindshëm të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurisë. Ai ka pasur të ardhura të ligjshme për të justifikuar pasuritë dhe shpenzimet e kryera prej tij dhe familjes. Subjekti ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tij dhe të familjes. Sikurse konfirmuar edhe nga ILDKPKI-ja, subjekti nuk ka kryer fshehje të pasurisë, nuk ka kryer deklarim të rremë të pasurisë, dhe nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave. Deklarimet e tij dhe të personave të lidhur, janë të vërteta, ndërsa pasaktësitë apo harresat në deklarimet periodike janë pakujdesi të cilat nuk cenojnë situatën e përgjithshme financiare dhe as dëshmojnë mungesë të burimeve financiare. Konkluzionet e Komisionit për kriterin e pasurisë janë të hamendësuar dhe të gabuara, sepse nuk janë rrjedhojë e një vlerësimi të drejtë e të paanshëm të shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, provave të paraqitura pas kalimit të barrës së provës, si dhe provave të administruara nga vetë Komisioni gjatë këtij procesi. Në kushtet ku rezultoi e provuar se subjekti nuk ka deklaruar dyfishin e pasurisë së ligjshme, gjetjet për kriterin e vlerësimit të pasurisë, nuk mund të përbëjnë shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra për këtë kriter, pasi bien ndesh me pikat 4 dhe 5, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, si dhe me nenet 59 dhe 61, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, në një interpretim sistematik e logjik të këtyre dispozitave të para së bashku. Për sa më sipër, subjekti arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, në kuptim të germës “a”, të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016. Në parashtrimet shtesë, subjekti ka potencuar edhe që kontrolli dhe vlerësimi i pasurisë nuk është kryer nën dritën e parimit të proporcionalitetit, referuar vendimit të GJEDNj-së “Sevdari kundër Shqipërisë”, i cili duhet të gjente zbatim edhe në rastin e tij, për shkak të ngjashmërisë në lidhje me pasuritë dhe të ardhurat nga puna në emigracion, të krijuara përpara fillimit të detyrës si prokuror.

5.1. Subjekti potencon konkluzionin e Komisionit *për pasurinë “autoveturë Volkswagen”*, blerë në datën 30.07.2015. Ai ka pasur aftësi paguese për blerjen e autoveturës objekt ankimi në vitin 2015, me të ardhurat e bashkëshortes së tij nga puna si notere. Balanca negative e konstatuar nga Komisioni është rezultat i vlerësimit të gabuar në lidhje me të ardhurat e bashkëshortes dhe me shpenzimet e kryera për këtë periudhë analize. Të ardhurat e bashkëshortes nga aktiviteti privat, nuk duhen konsideruar si të realizuara në mënyrë përpjesëtimore gjatë vitit, por sipas gjendjes faktike për shtatëmujorin e parë. Komisioni ka bërë dublim të shpenzimeve të jetesës duke ripërfshirë në këtë analizë si zëra të veçantë, “shpenzimet e transportit” dhe “shpenzimet e hipotekës”, zëra të cilat janë të përfshirë brenda shpenzimeve jetike të përlloritura nga ILDKPKI-ja, sipas anketës së buxhetit të vitit 2014.

5.2. Në lidhje me pasurinë 3.300 euro, gjendje në llogari në datën 31.01.2017, pranë bankës Raiffeisen, subjekti pretendon se ka pasur mundësi financiare për krijimin e kësaj depozite, me origjinë depozitën fillestare prej 20.000 eurosh, nëpërmjet kursimeve nga paga si Oficer i Policisë Gjqësore (referuar në vijim me shkurtimin OPGj). Për rrjedhojë, deklarimi në deklaratën *vetting* është i saktë, sipas shpjegimeve përkatëse në përgjigjet e rezultateve të hetimit administrativ, të cilave u qëndron edhe në ankim.

5.3. Fokusuar në konkluzionin e Komisionit për pasurinë *apartament, të ndodhur në {***}, Vlorë*, për deklarim kontradiktor e të pamjaftueshëm dhe për veprime që cenojnë besimin e publikut, subjekti e kundërshton atë në tërësi. Çmimi i apartamentit është real dhe dyshimet e Komisionit se kjo pasuri është njësi shërbimi, vijnë në kundërshtim me dokumentacionin e paraqitur prej tij. Subjekti ka pasur aftësi paguese për blerjen e apartamentit, në pjesën më të madhe me të ardhurat nga emigracioni, të cilat duhet të njihen si të ligjshme. Ai nuk mund të penalizohet në këtë drejtim, për detyrime tatimore të papaguara nga punëdhënësi i tij në Itali, 25 vite më parë. Për pjesën tjetër të financuar nga prindërit, subjekti e ka pasur të pamundur të saktësojë vlerën e këtij kontributi, për shkak të mosmbajtjes shënime dhe kohës së largët të blerjes së apartamentit. Nuk ka asnjë të dhënë që kjo pasuri është e fshehur dhe në këto kushte, Kolegji duhet të analizojë vlerën e kësaj pasurie, nën dritën e konceptit të dyfishit të pasurisë së ligjshme.

5.4. Lidhur me likuiditetet “*gjendje cash*” në shumën 1.500.000 lekë, subjekti e gjen të pabazuar konkluzionin e Komisionit për deklarime kontradiktore për burimin e të ardhurave dhe pamjaftueshmërinë e tyre për krijimin e këtij likuiditeti. Subjekti ka pasur mjaftueshëm të ardhura nga puna në emigracion, të cilat kanë shërbyer si burim për krijimin e kësaj gjendjeje *cash* dhe mungesa e të dhënave lidhur me këto të ardhura nuk duhet të penalizojë subjektin. Në deklaratat periodike dhe atë *vetting*, subjekti ka deklaruar saktë burimin e krijimit të kësaj depozite, duke cilësuar të tillë të ardhurat nga emigracioni. Deklarimi i të ardhurave nga puna si OPGj si burim krijimi për këtë pasuri, duhet konsideruar si pasaktësi e subjektit gjatë hetimit administrativ dhe jo si deklarim kontradiktor, me pasojë penalizimin e tij.

5.5. Sa i përket *veprimtarisë tregtare “impiant gazi”*, për të cilën Komisioni vlerësoi nën dritën e cenimit të besimit të publikut mosdhënien e shpjegimeve dhe dokumenteve të kërkuara në kuadër të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit pretendon se nuk ka kryer veprimtari private gjatë ushtrimit të detyrës si prokuror, referuar akteve ligjore e nënligjore që rregullojnë statusin, etikën dhe konfliktin e interesit.

5.6. Për *huan me vlerë 17.000 euro, dhënë pa afat dhe pa interes, mikut të tij, të ndjerit B. E.*, subjekti pretendon se ka pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e shumës 20.000 euro, e për rrjedhojë edhe për dhënien e huas objekt analize. Në analizën financiare duhet të përfshihen: (a) të ardhurat e realizuara nga puna e subjektit në emigracion; (b) financimi nga babai i tij, i një pjese të shpenzimit të transfertës bankare në emër të një përmbaruesi gjyqësor; (c) shuma 1.121.714 lekë depozituar në llogarinë e vajzës së tij, e cila është dhuruar nga babai i subjektit.

5.7. Sa i përket *analizës së përgjithshme financiare*, subjekti kundërshton konkluzionin e Komisionit se balanca negative për periudhën e rivlerësimit prej 2.175.219 lekësh, përbën shkak për penalizim të subjektit të rivlerësimit. Sipas pretendimit, kjo balancë negative është rrjedhojë e metodologjisë së gabuar të aplikuar prej Komisionit lidhur me të ardhurat dhe shpenzimet. Subjekti kërkon: (a) të pranohen të ardhurat e përfituara nga emigracioni në Itali si edhe kontributi financiar i babait të tij, qoftë për një pjesë të transfertës në BKT në favor të përmbaruesit gjyqësor, qoftë për pasuritë e krijuara përpara fillimit të detyrës; (b) subjekti ka arritur në një nivel të besueshëm në vlerësimin e kriterit të pasurisë. Gjetjet për këtë kriter nuk mund të përbëjnë shkak për marrjen e

masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, nën dritën e dyfishit të pasurisë së ligjshme sipas përcaktimit të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.

III/3. Shkaqet e ankimit lidhur me kriterin e vlerësimit profesional

6. Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit, qoftë sa i përket vlerësimit si “të papërshtatshëm profesionalisht”, ashtu edhe për cenim të besimit të publikut. Subjekti pretendon se: (a) Komisioni ka shtrirë hetimin për çështje penale të hetuara jashtë periudhës së rivlerësimit, të përcaktuar në ligjin nr. 84/2016; (b) Vlerësimi “i papërshtatshëm profesionalisht” vjen në kundërshtim me raportin e KLP-së, i cili e ka vlerësuar pozitivisht subjektin bazuar në kontrollin ushtruar dosjeve penale që rezultuan pa problematika dhe në dokumentacionin e administruar, sipas të cilit nuk rezultuan në ngarkim të subjektit masa disiplinore e as materiale hetimore apo procedime penale; (c) Komisioni ka shkelur nenin 6 të KEDNj-së, pasi ka vendosur shkarkimin e subjektit për veprime apo mosveprime për të cilat nuk i ka kaluar barrë prove. E vetmja barrë prove i përkiste vetëm një çështjeje, e cila është jashtë periudhës së rivlerësimit; (ç) Edhe ndonjë gabim i konstatuar nuk përbën në asnjë rast shkelje të rëndë, pasi mund t’i ndodhë në rrethana normale çdo magjistrati me nivel mesatar; (d) Subjekti nuk ndodhet në kushtet e pikës 5, të nenit E, të Aneksit të Kushtetutës, pasi nuk ka kryer veprime që kanë penguar e vështirësuar procesin e rivlerësimit të aftësive profesionale. Komisioni ka bërë interpretim të gabuar të kësaj dispozite, e cila konsideron si “pengim apo vështirësim të vlerësimit” veprimet konkrete të kryera nga subjektet e rivlerësimit dhe jo mosdhënien e shpjegimeve, sipas interpretimit të Komisionit. Nga ana tjetër, ky vlerësim është bërë në interpretim të gabuar edhe të nenit 52 të ligjit 84/2016, i cili barrën e provës e përcakton si një të drejtë të subjektit të rivlerësimit, dhe jo një detyrim për të.

III/4. Shkaqet e ankimit lidhur me cenimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë

7. Komisioni ka gabuar në konkluzionin e nxjerrë në vlerësimin tërësor të rrethanave, se me veprimet dhe mosveprimet e tij, subjekti ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, sipas parashikimit të nenit 61, pika 5 të ligjit nr. 84/2016. Sipas subjektit: (a) cenimi i besimit të publikut përbën shkak shkarkimi bazuar vetëm në vlerësimin tërësor të të tria kriterëve të rivlerësimit; (b) Komisioni ka bërë interpretim të gabuar të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, duke e vlerësuar mosdhënien e shpjegimeve prej subjektit, si sjellje që ka penguar procesin e vlerësimit; (c) Konkluzioni për cenimin e besimit vjen në kundërshtim me jurisprudencën e Kolegjit, sipas të cilës, cenimi i besimit të publikut konsiderohet shkak shkarkimi vetëm për shkelje ligjore të cilat nuk përbëjnë shkak për aplikimin e rasteve të tjera të shkarkimit, të parashikuara nga pikat 1, 2, 3 dhe 4, të nenit 61 të këtij ligji.

IV. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Mbi procesin gjyqësor në Kolegj

A/i. Juridiksioni i Kolegjit

8. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion *ratione materiae* për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve

të Komisionit, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit 5, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja me objekt shqyrtimi kundërshtimin e vendimit të Komisionit, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit. Trupi gjykues i Kolegjit, me përbërjen si në pjesën hyrëse të këtij vendimi, është rezultat i shortit të zhvilluar në datën 20.04.2022, i cili është publikuar në internet, në faqen zyrtare të Kolegjit⁴.

A./ii. Legjitimimi i ankuesit

9. Ankuesi legjitimohet *ratione personae*, duke qenë subjekt rivlerësimi në kuptim të dispozitave kushtetuese e ligjore që rregullojnë këtë aspekt, dhe *ratione temporis*, në kushtet që ankimi i depozituar pranë Komisionit mban datën 31.03.2022⁵, brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar,⁶ në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

A./ii. Forma dhe mënyra e shqyrtimit të çështjes në Kolegjin e Posaçëm të Apelit

10. Pasi analizoi kërkesat procedurale të subjektit të rivlerësimit, për kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore publike, riçeljen e hetimit gjyqësor, administrimin e provave që janë pjesë e dosjes së Komisionit dhe atyre bashkëlidhur ankimit, trupi gjykues i Kolegjit vendosi të shqyrtojë ankimin në *dhomë këshillimi*, nën dritën e pikës 1, të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012⁷ të thirrur për zbatim nga neni 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016. Nga analiza e kryer në Kolegj rezultoi se në këtë çështje nuk gjen zbatim asnjë nga rrethanat e përcaktuara në ligj⁸, që do të diktonin nevojën për kalimin në seancë gjyqësore publike, në praninë e subjektit.

10.1. Aktet shkresore bashkëlidhur ankimit⁹, nuk plotësojnë kriteret e parashikuara në nenin 47 të ligjit nr. 49/2012, për rastet përjashtimore që normon ligji për provat e reja që lejohen me ankimin. Jo vetëm që këto akte nuk pasqyrojnë të dhëna të prodhuara për herë të parë, pasi Komisioni ka dhënë vendimin objekt ankimi, por nga shqyrtimi i shkaqeve të ankimit nuk rezulton që subjekti të ketë pretenduar të ketë qenë në pamundësi për paraqitjen e tyre në Komision.

10.2. Edhe duke abstraguar nga sa më sipër, në kontekstin e përcaktimeve të nenit 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, aktet e sjella nga subjekti u gjetën të panevojshme dhe jopërcaktuese për procesin dhe zgjidhjen përfundimtare.

⁴ <https://kpa.al/njoftim-795/>

⁵ Regjistruar në Komision me nr. {***} prot., datë 02.04.2022.

⁶ Vendimi i arsyetuar i është njoftuar subjektit të rivlerësimit në datën 16.03.2022.

⁷ “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

⁸ Neni 51 i ligjit nr. 49/2012 përcakton: “[1.] Gjykata, në *dhomë këshillimi*, vendos shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve, në rast se çmon se debati gjyqësor është i nevojshëm për të vlerësuar se: a) për konstatimin e gjendjes faktike në mënyrë të plotë dhe të saktë, duhen vërtetuar fakte të reja dhe duhen marrë prova të reja kur janë kushtet e nenit 47 të këtij ligji; b) vendimi kundër të cilit është paraqitur ankimi është bazuar në shkelje të rënda procedurale, apo në gjendjen faktike të konstatuar gabimisht ose në mënyrë jo të plotë; c) me qëllim të konstatimit të drejtë të gjendjes faktike duhet të përsërisë marrjen e disa ose të gjitha provave të marra nga gjykata e shkallës së parë. [...]”.

⁹ Listuar më lart, në poshtëshënimin nr. 3.

kohë pas tij, trajtimi i mëtejshëm e i përsëritur i analizës që ka shoqëruar këtë argument, çmohet i panevojshëm dhe i pakuptimtë.

11.2. Aspekti tjetër i argumenteve, që lidhet me kriteret e zgjedhshmërisë së anëtarëve të trupit gjykues të Komisionit – në funksion të së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e krijuar me ligj, e pavarur dhe e paanshme, nën dritën e nenit 6, pika 1 të KEDNj-së dhe praktikës së GjEDNj-së referuar çështjes “Volkov kundër Ukrainës”, është po ashtu i pabazuar. Trupi gjykues rikonfirmon sa është trajtuar gjerësisht në jurisprudencën e Kolegjit¹¹ për kriteret e zgjedhshmërisë së anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit, nën dritën e natyrës *sui generis* të procesit të rivlerësimit dhe qëllimit të ligjvënësimit për të zgjedhur procedura të mirëpërcaktuara nga Aneksi i Kushtetutës dhe ligji i posaçëm nr. 84/2016. Për më tepër, dhe sikurse është arsyetuar në këto vendime të mëparshme të Kolegjit, vendimi i Komisionit i nënshtrohet kontrollit të Kolegjit, duke mundësuar në këtë mënyrë, nën dritën e arsytimit të GjEDNj-së në çështjen *Astradsson* kundër Islandës, korrektimin e kërkuar si një ndër aspektet nëpërmjet të cilave shërohen problematikat që mund të lindin si pasojë e kontestimit nëse gjykata është krijuar me ligj. Po ashtu dhe si *obiter dictum*, subjekti është njohur me trupin gjykues të Komisionit që më 20.01.2020, dhe nuk rezulton të ketë parashtruar asnjë kundërshtim për të, përfshirë edhe për gjendjen e ndonjë prej komisionerëve në kushte të konfliktit të interesit me të. Për rrjedhojë, ky argument i ngritur për herë të parë në ankim, paraqitet më tepër si një përpjekje për të gjetur argumente për të cilat të kontestohet vendimi në tërësi, sesa si pasqyrim i një shqetësimi të mirëfilltë të subjektit.

11.3. Në vijim, rezulton i pabazuar edhe pretendimi i subjektit se vendimi objekt ankimi, është rezultat i një procesi të paragjykuar e të paracaktuar apo që Komisioni ka vepruar “nën doza të larta paragjykimi”. Subjekti i rivlerësimit pretendon se paragjykimi pasqyrohet në mospranimin nga Komisioni të “asnjë” argumenti të paraqitur prej tij. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se ky pretendim është i pambështetur në ligj, pasi ka lidhje me vlerësimin e provave sipas përcaktimeve të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenit 81 të Kodit të Procedurave Administrative. Vlerësimi i Komisionit, jo domosdoshmërisht mund të konfirmojë argumentet dhe qëndrimin e subjektit për çështje të caktuara. Në këtë kuptim, qëndrimi ndryshe nuk e bën Komisionin subjektiv apo paragjykues. Mbi të gjitha, ky pretendim, përveçse i pabazuar në ligj, rezulton edhe i pavërtetë, referuar rrethanave konkrete faktike. Në vendim, nuk vërehen elemente paragjyquese nga Komisioni, të shprehur apo të nënkuptuar. E kundërta rezulton nga aktet. Në disa raste, shpjegimet e subjektit janë marrë në konsideratë nga Komisioni, duke ndryshuar rezultatin paraprak të hetimit. Referuar pikave 88.1 - 88.2 të vendimit, rezulton se Komisioni, pasi ka marrë në analizë pasurinë depozitë pa afat në Raiffeisen Bank, në emër të bashkëshortes së subjektit, në shumën 350.000 lekë, e ka konsideruar subjektin dhe bashkëshorten e tij me mundësi për krijimin e saj, ndonëse nga analiza financiare për këtë pasuri, ata kanë rezultuar me balancë negative. Nëse do të udhëhiqej nga doza paragjykimi, Komisioni, bazuar në rezultatin negativ, nuk do të kishte mbërritur në këtë konkluzion. Po ashtu, edhe arsytimi në pikën nr. 97 të vendimit, provon të kundërtën e pretendimit të subjektit. Konkretisht, Komisioni ka pranuar shpjegimin e subjektit në hetimin administrativ

¹¹ Vendimi nr. 43/2022 (JR), paragrafi 14.2. i-iv, që i përket s. r. H. M., vendimi nr. 3/2023 (JR), datë 06.02.2023, prg. 10.1.1, ndaj s. r. T. H. etj.

lidhur me gjendjen *cash* të bashkëshortes së subjektit, e cila në deklaratën para fillimit të detyrës të vitit 2014, është deklaruar në shumën 3 milionë lekë, ndërsa sipas shpjegimit të subjektit, vlera është në fakt [gjendja e *cash-it*] 300.000 lekë. Në këtë analizë, Komisioni, jo vetëm i ka pranuar si bindëse shpjegimet e subjektit për pasaktësinë në deklaram, por në baza tërësisht deklarative, ka pranuar të mirëqenë edhe mundësinë e saj për kursimin në *cash* në masën 100% të të ardhurave të realizuara në këtë periudhë, duke e favorizuar subjektin, në kushtet që nuk ka hetuar për shpenzime të mundshme të kësaj shume.

11.4. Pretendimi se hetimi administrativ ka qenë i paplotë dhe që Komisioni ka kryer vlerësim jo të drejtë e jo të paanshëm të provave, po ashtu nuk gjen mbështetje në aktet në dosje. Nga shqyrtimi i raportit të rezultateve të hetimit dhe nga kontrolli i vendimit të Komisionit, hetimi i kryer rezulton i plotë dhe në pasqyrim të analizës së fakteve dhe rrethanave. Komisioni ka marrë në analizë provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë *vetting*, raportet e pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale të dorëzuara nga institucionet respektive, denoncimet e publikut e informacionet nga burime të hapura (mediat), dokumentet ligjorë, dokumentet e administruara nga organet publike dhe private, deklaramet dhe përgjigjet e subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, dhe pas mbylljes së hetimeve, dhe së fundmi, edhe argumentimet e përfaqësueses ligjore të subjektit në seancën dëgjimore. Fakti që Komisioni ka kryer edhe vetë hetim të pavarur dëshmohep nëpërmjet korrespondencave shkresore me institucione të tjera¹². Dokumentacioni i përfutur gjendet i administruar në përmbajtje të fashikujve hetimorë. Këto shkresa të administruara në cilësinë e provës rezultojnë gjithashtu edhe të analizuara në vendim dhe janë cituar në përmbajtje të vendimit.

11.5. Si shembull, trupi gjykues çmon të theksojë, ndër të tjera, korrespondencat me prokuroritë e rretheve gjyqësore Fier, Vlorë dhe me Prokurorinë e Posaçme, të zhvilluara në kuadër të verifikimit për konflikt të mundshëm interesi të subjektit të rivlerësimit me disa persona e shoqëri¹³. Kryerja e një hetimi të pavarur nga Komisioni, është pranuar në seancë dëgjimore edhe nga përfaqësuesja e subjektit, e cila referuar procesverbalit të kësaj seance, e falënderon madje Komisionin për gjithë hetimin e kryer, pavarësisht se DSIK-ja ndryshoi konkluzionin e vet. Edhe vetë subjekti pranon në ankim se Komisioni ka kryer hetim të pavarur në drejtim të kriterit të vlerësimit të pasurisë.

11.6. Në të njëjtën linjë, edhe pretendimi për vlerësim jo të drejtë dhe jo të paanshëm të provave, nuk gjen mbështetje. Vendimi objekt ankimi karakterizohet nga një analizë e thelluar e provave të administruara gjatë hetimit, qoftë atyre të marra nga vetë Komisioni, ashtu edhe atyre të sjella nga vetë subjekti i rivlerësimit. Si e tillë mund të përmendim ndër të tjera analizën në paragrafin 39 dhe 40 të vendimit, lidhur me aktet shkresore të sjella nga subjekti për të ardhurat e prindërve, si pasojë e së cilës ka ndryshuar rezultati paraprak i hetimit, dhe janë konsideruar me burime të ligjshme shumat e derdhura nga prindërit e subjektit në depozitat bankare të vajzave të tij.

¹² Komisioni ka kërkuar informacion zyrtar, ndër të tjera nga ASHK (ish-ZRPP), ish-ALUIZNI, DPSHTRr, QKB, Drejtoria e Tatimeve, FSHU, UKT, institucionet bankare, Prokuroria e Përgjithshme e prokuroritë e rretheve, Prokuroria e Posaçme.

¹³ D. Ç., shoqërinë {***} ShPK, B. E., arsyetuar në pikat 46.4 e 81 të vendimit objekt shqyrtimi.

Komisioni ka përfshirë në analizën financiare të subjektit, në zërin e të ardhurave, vlerën 1.500 euro (para fillimit të detyrës) dhe 89.025 lekë (pas fillimit të detyrës - viti 2014). Në vijim, një tjetër dëshmi e kësaj qasjeje pranuese është edhe analiza që Komisioni i bën dokumentit shkresor të paraqitur nga subjekti në ushtrim të barrës së provës, për të vërtetuar pretendimin e tij për punësimin pranë shoqërisë “{***}”, në Itali.

11.7. Fakti që subjekti i konsideron pretendimet e veta të mbështetura në provat e sjella, jo domosdoshmërisht vlerësohet nën të njëjtën optikë edhe nga Komisioni, i cili vlerësimin e provave e bën në përputhje me pikën 4, të nenit 49, të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin 81 të Kodit të Procedurës Administrative. Optika e ndryshme e vlerësimit nga Komisioni, nuk nënkupton mungesë të analizimit të provave, vlerësim jo të drejtë, njëanshmëri apo subjektivizëm, por një analizë ndryshe që ka prodhuar një konkluzion të ndryshëm nga qëndrimi i subjektit, dhe në këtë kuptim, ky qëndrim ndryshe nuk e bën Komisionin as subjektiv dhe as të njëanshëm. Për sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit çmon se vlerësimi i provave nga Komisioni nuk rezulton të jetë pasojë e mosadministrimit apo e mosanalizimit, por rrjedhë e vlerës provuese të tyre në raport me kërkesat ligjore.

11.8. Subjekti pretendon se i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, pasi nuk janë respektuar disa parime themelore që garantojnë këtë të drejtë, sikurse janë e drejta për t'u mbrojtur e dëgjuar dhe parimi i kontradiktoritetit. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, trupi gjykues i Kolegjit vëren se ky pretendim është i pabazuar në fakte. Komisioni i është drejtuar subjektit me katër (4) pyetësorë në të cilët ai ka dhënë shpjegimet e tij. Pas njoftimit të rezultateve të hetimit administrativ dhe njohjes me aktet e dosjes, subjekti ka depozituar shpjegime dhe prova. Ai ka bërë disa kërkesa për shtyrje afatesh¹⁴, të cilat janë pranuar nga Komisioni. Çështjet dhe problematikat që kanë çuar Komisionin drejt vlerësimit për dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, janë të njëjtat me ato të evidentuara në raportin e rezultateve paraprake të hetimit, përcjellë subjektit të rivlerësimit. Referuar procesverbalit të seancës dëgjimore, rezulton se Komisioni -- përveçse me rezultatet e hetimit -- i ka dhënë mundësinë subjektit edhe në seancë, të japë shpjegime e të depozitojë dokumente të tjera. Të gjitha këto detaje konkrete të procesit të kryer për subjektin nga Komisioni, dëshmojnë se atij i janë respektuar të gjitha garancitë për proces të rregullt. Ai është dëgjuar, ka dhënë shpjegime e sjellë prova, ka kërkuar kohë shtesë, e cila i është dhënë. Së fundmi, nga aktet në fashikull, nuk rezulton që subjekti të ketë pasur kërkesa të tjera procedurale për efekt të procesit të rregullt apo të ketë kundërshtuar veprime të caktuara të Komisionit, nën dritën e parimeve të procesit të rregullt.

11.9. Edhe pretendimi tjetër i subjektit, se me rezultatet e hetimit nuk i është njoftuar se në cilën situatë ligjore të parashikuar në nenin 61 të ligjit nr. 84/2016, dyshohej se ndodhej, është i pabazuar. Në kontekstin e aspektit procedural, trupi gjykues i Kolegjit çmon të nënvizojë që, gjetjet e njoftuara me rezultatet e hetimit janë të njëjta me ato të analizuara në vendim, dhe subjekti, për shkak të barrës së provës, duhet të ishte i ndërjegjshëm për situatën ligjore në të cilën ndodhet,

¹⁴ Kërkesa e bashkëshortes së subjektit datë 22.01.2020 për shtyrjen e afatit të dhënies së përgjigjeve për shkak të gjendjes jo të mirë shëndetësore të subjektit; kërkesë për shtyrjen e seancës dëgjimore dërguar nga përfaqësuesja e subjektit.

nëse nuk do të provonte të kundërtën. Edhe rëndësia e të qenit bashkëpunues gjatë hetimit administrativ, në kuptim të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, i është bërë me dije që me dërgimin e pyetësorit standard, por edhe në komunikime të tjera¹⁵. Në këto kushte, nuk mund të argumentohet se subjekti nuk ka qenë në dijeni të rëndësisë që paraqet bashkëpunimi i tij në procesin e rivlerësimit. Për rrjedhojë, neglizhenca e treguar nga subjekti (në rastin më të mirë), nuk mund të argumentohet se lehtësonte procesin. Po kështu, në seancën dëgjimore, Komisioni është ndalur në disa momente të konstatimit të mosbashkëpunimit të subjektit të rivlerësimit, duke i kërkuar përfaqësueses ligjore të japë shpjegime për mosinteresimin e subjektit për çështje të caktuara. Përgjigjet e përfaqësueses kanë qenë të përcipta, dhe duken si një përpjekje e momentit për t'iu larguar thelbit të pyetjeve. Këto fakte tregojnë se subjektit i është bërë me dije që mënyra e zgjedhur prej tij për të ndërvepruar me Komisionin dhe iu nënshtruar procesit, nuk përputhej me pritshmëritë.

11.10. Në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, vlerësimi tërësor shtrihet mbi të gjitha rrethanat e konstatuara. Në vendimin objekt ankimi, Komisioni ka arsyetuar se qëndrimet e subjektit gjatë procesit të rivlerësimit, janë mbajtur në konsideratë gjatë procesit të vendimmarrjes, sipas parashikimit të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, dhe konkluzioni për cenimin e besimit të publikut është marrë në vlerësimin tërësor të rrethanave. Është e logjikshme që cenimi i besimit të publikut *nuk* mund të vinte si konkluzion në fazën e hetimit. Madje, Komisioni do të kishte qenë literalisht në kushtet e paragjykimit nëse do të ishte shprehur për këtë konkluzion përpara seancës dëgjimore. Në këto kushte, konkluzioni në fjalë është derivat i gjithë procesit, pasi subjekti i është dhënë edhe mundësia të dëgjohej në seancën dëgjimore për efekt të mbrojtjes dhe përmbysjes së barrës së provës. Nga ana tjetër, gjatë seancës dëgjimore, subjekti vijoi me të njëjtën qasje, duke mos dhënë shpjegime apo duke zgjedhur të japë shpjegime të përcipta.

11.11. Së fundmi, procesverbali i seancës dëgjimore tregon se përfaqësuesja e subjektit nuk ka kontestuar dhe as ka ngritur pretendime për cenimin e të drejtave procedurale, kur është përmbledhur qëndrimi i Komisionit nga relatorja, apo në ndonjë moment tjetër gjatë seancës dëgjimore. Këto pretendime, të cilat ngrihen për të parën herë në ankim, vlerësohen nga trupi gjykues i Kolegjit si një përpjekje e subjektit për ta bërë procesin e rivlerësimit të duket si i zhvilluar në shkellje të parimit të procesit të rregullt ligjor.

B.2. Analiza e shkaqeve të ankimit që lidhen me kriterin e pasurisë

B.2.1. Shkaqe të përgjithshme që lidhen me aspektin procedural e ligjor të hetimit dhe vlerësimit të kriterit të pasurisë

12. Subjekti i rivlerësimit pretendon se arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë dhe se e kalon testin e standardit kushtetues të të provuarit bindshëm të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurisë, pasi ka pasur të ardhura të ligjshme për të justifikuar pasuritë dhe shpenzimet e kryera prej tij dhe familjes. Subjekti ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tij dhe të familjes.

¹⁵ Email-in e datës 02.02.2022, ku ndër të tjera Komisioni i rikujton subjektit se bashkëpunimi me Komisionin mbahet në konsideratë në vlerësimin përfundimtar sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 dhe në vlerësim të të gjitha rrethanave të çështjes.

Sikurse konfirmuar edhe nga ILDKPKI-ja, subjekti nuk ka kryer fshehje të pasurisë, nuk ka kryer deklarim të rremë të pasurisë, dhe nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave. Deklarimet e tij dhe të personave të lidhur, janë të vërteta, ndërsa pasaktësitë apo harresat në deklarimet periodike, janë pakujdesi të cilat nuk cenojnë situatën e përgjithshme financiare dhe as dëshmojnë mungesë të burimeve financiare. Konkluzionet e Komisionit për kriterin e pasurisë janë të hamendësuar dhe të gabuara, sepse nuk janë rrjedhojë e një vlerësimi të drejtë e të paanshëm i shpjegimeve dhe provave të administruara. Kontrolli dhe vlerësimi i pasurisë nuk është kryer nën dritën e parimit të proporcionalitetit, referuar vendimit të GJEDNj-së në çështjen “Sevdari kundër Shqipërisë”, i cili duhet të gjente zbatim edhe në rastin e tij, për shkak të ngjashmërisë për pasuritë dhe të ardhurat nga puna në emigracion, të krijuara përpara fillimit të detyrës si prokuror. Së fundmi, subjekti pretendon se, në kushtet ku rezultoi e provuar se nuk ka deklaruar dyfishin e pasurisë së ligjshme, gjetjet për kriterin e vlerësimit të pasurisë nuk mund të përbëjnë shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra për këtë kriter, pasi bien ndesh me pikat 4 dhe 5, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, si dhe me nenet 59 dhe 61, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, në një interpretim sistematik e logjik të këtyre dispozitave të para së bashku.

12.1. Shqyrtimi i aspekteve të themelit të pretendimit për nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, shtjellohet në vijim. Në drejtim të aspektit procedural e ligjor, bazuar në aktet në fashikull, nën dritën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim, trupi gjykues i Kolegjit vëren se këto pretendime të subjektit rezultojnë të pambështetura në ligj dhe në akte. Arsyetimi mbi të cilin bazohet ky konkluzion, shtjellohet në vijim.

12.2. Së pari, sikurse arsyetuar gjerësisht, në mënyrë të përsëritur në vendime të mëparshme të Kolegjit, në vendimin nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese, dhe në kontrollin e arsyetimit e GJEDNj-së në çështjen kyç “Xhoxhaj”, kuadri ligjor¹⁶ që rregullon procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve ka përcaktuar që organet e rivlerësimit janë autonome dhe kryejnë hetim të pavarur.¹⁷ Raportet e institucioneve ndihmëse -- ILDKPKI, DSIK, KLGj e KLP -- i nënshtrohen vlerësimit nga organet e rivlerësimit, bazuar në dispozitat e ligjit nr. 84/2016. Në këto kushte, organet e rivlerësimit kryejnë një proces kontrolli të pakushtëzuara nga përfundimet e paraqitura nga organet ndihmëse. Për rrjedhojë, sikurse arsyetuar edhe më sipër, në kushtet që edhe ky pretendim i subjektit ka gjetur përgjigje shteruese e përfundimtare më së paku në çështjen “Xhoxhaj”, që në maj 20121, thajse një vit përpara se subjekti të ushtronte ankimin, trupi gjykues vëren se është e panevojshme të ndalet më tej në këtë aspekt.

12.3. Për sa i përket argumenteve për vlerësimin e pasurisë së subjektit nën dritën e parimit të proporcionalitetit, referuar vendimit të GJEDNj-së në çështjen “Sevdari kundër Shqipërisë”, trupi gjykues i Kolegjit nuk evidenton ngjashmëri midis këtyre dy rasteve (arsyetuar në vijim të këtij vendimi). Po ashtu, në linjë me qëndrime të mbajtura në raste të tjera të ngjashme, trupi gjykues i Kolegjit rikonfirmon që, ndarja e përgjegjësisë së subjekteve në raport me pasuritë e vëna para dhe pas periudhës së emërimit si magjistrat, do të ishte e pajustificueshme për qëllimet e kontrollit të pasurisë, sidomos për ata individë që si subjekti kanë qenë pjesë e sistemit të drejtësisë për shkak

¹⁶ Neni Ç, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, neni 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 dhe dispozitat e Kreut IV të të njëjtit ligj.

¹⁷ Nenet 45 dhe 49 të ligjit nr. 84/2016.

të ushtrimit të detyrës së Oficerit të Policisë Gjyqësore, në rastin konkret që prej vitit 2005, vit në të cilin ka qenë madje edhe subjekt deklarues i pasurisë. Kjo qasje do të ishte në kundërshtim me Aneksin e Kushtetutës, ligjin nr. 84/2016 dhe jurisprudencën e Kolegjit, të cilat nuk përjashtojnë verifikimin e pasurive të krijuara nga subjektet e rivlerësimit përpara marrjes së detyrës, pavarësisht kohës në të cilën janë krijuar. Në këtë kontekst, ndarja e analizës financiare sipas periudhave, e aplikuar në rastin konkret nga Komisioni (dhe Kolegji për pasojë), prezumohet të jetë kryer nga Komisioni vetëm për shkak të mungesës të deklarimeve periodike vjetore deri kur subjekti është emëruar prokuror -- më 20.06.2014 dhe jo për të diferencuar përgjegjësitë për pasuritë e vëna përpara dhe pas fillimit të detyrës. Në të kundërt, zbatimi i kriterit të ligjshmërisë në pasuritë e krijuara përpara dhe pas emërimit prokuror, në kushtet konkrete të subjektit, që gjithsesi ka qenë funksionar publik dhe pjesë e prokurorisë e ka kryer detyra të caktuara për efekt të hetimit të veprave penale, do të ishte i pabazuar në synimin e procesit të rivlerësimit në parim, dhe në rrethanat e subjektit, në praktikë. Së fundmi, balanca e përgjithshme negative prej (-) 7.391.439 lekësh,¹⁸ e rezultuar në Kolegji për të gjithë periudhën, e përjashton mundësinë e vlerësimit të kriterit të pasurisë nën dritën e parimit të proporcionalitetit.

12.4. Edhe pretendimi tjetër i subjektit, që kushtëzon konstatimin për deklarim të pamjaftueshëm në kuptim të nenit 61, pika 3, me shkelje “në nivel të krahasueshëm ose të njëjtë me fshehjen” e pasurisë, ka gjetur arsytim të gjerë e të konsoliduar në vendime të mëparshme të Kolegjit, në një sërë çështjesh të shqyrtuara e konfirmuara më parë. Për rrjedhojë, trupi gjykues i Kolegjit rikonfirmon edhe në këtë rast, qëndrimin e deritanishëm në jurisprudencën e Kolegjit¹⁹, se shkaqet që passjellin marrjen e masës disiplinore, janë autonome, dhe jo të kushtëzuara nga njëra-tjetra. Deklarimi i dyfishit të pasurisë është vetëm një ndër gjashtë situatat për të cilat mund të merret masa disiplinore, ajo në të cilën organet e rivlerësimit nuk kanë diskrecion përpos shkarkimit automatik. Kjo mënyrë leximi e interpretimi e organeve të rivlerësimit ka kaluar tashmë edhe testin e kontrollit të kryer nga GjEDNj-ja, duke nisur nga çështja kyç “Xhoxhaj kundër Shqipërisë”, ndër të tjera, e cila ka lënë në fuqi vendimet e Kolegjit bazuar në këtë interpretim të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Për sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se ky shkak ankimi është i pabazuar.

B.2.2. Shkaqet e ankimit që lidhen me vlerësimin e pasurive

I. Pasuria “autoveturë Volkswagen”, blerë në datën 30.07.2015, kundrejt çmimit 700.000 lekë

13. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti ka deklaruar pronësinë e tij mbi automjetin “Volkswagen” me vlerë 700.000 lekë, të blerë me të ardhurat e bashkëshortes nga puna si notere, duke rikonfirmuar deklarin e bërë në DIPP-në e vitit 2015. Referuar dokumentacionit bashkëlidhur deklaratës *vetting*, ky automjet është blerë me kontratën e shitblerjes të datës 30.07.2015, me palë blerëse subjektin e rivlerësimit. Në bazë të rezultatit financiar negativ në

¹⁸ Për periudhën 2005 – 20.06.2014 (para fillimit të detyrës si prokuror) në vlerën (-) 7.157.899 lekë dhe (ii) për vitin 2015 në vlerën (-) 233.540 lekë.

¹⁹ Vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit: nr. 19/2019, paragrafi 22.15, që i përket subjektit XH. Z.; nr. 1/2021, paragrafi 20-20.1, që i përket subjektit A. S.; nr.16/2022, paragrafi 23, për subjektin M. V.; nr. 33, datë 29.07.2022, paragrafi 19, për subjektin A. XH. etj.

vlerën (-) 112.058 lekë për periudhën 01.01.2015 - 30.07.2015, Komisioni ka konkluduar se subjekti nuk ka pasur mjaftueshëm të ardhura të ligjshme për të blerë automjetin objekt verifikimi.

13.1. Subjekti i rivlerësimit, nën të njëjtën linjë arsyetimi me prapësimet kundër rezultateve të hetimit, ka potencuar në ankim, se ka pasur aftësi pagueuse për blerjen e autoveturës në fjalë në vitin 2015, me të ardhurat sipas burimit të deklaruar. Balanca negative e konstatuar nga Komisioni, është rezultat i përlllogaritjes së gabuar e të ardhurave të bashkëshortes nga noteria, sikurse edhe i shpenzimeve të jetesës. Sipas subjektit, Komisioni ka gabuar në llogaritjen e të ardhurave të bashkëshortes nga aktiviteti, duke aplikuar të njëjtën metodologji përpjesëtimore si edhe për llogaritjen e fitimit. Këto të ardhura nuk janë realizuar në mënyrë përpjesëtimore dhe rezultojnë më të larta në shtatëmujorin e parë të vitit në fjalë.

13.2. Pas kontrollit të ushtruar mbi analizën financiare të Komisionit, subjekti i rivlerësimit rezultoi edhe në Kolegj, me balancë negative të burimeve financiare të ligjshme në shumën (-) 91.243 lekë, për krijimin e autoveturës objekt vlerësimi dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, në kuptim të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016. Në këtë vlerësim, trupi gjykues u bazua në situatën faktiko-ligjore që rezultoi në Kolegj pas shqyrtimit të pretendimeve të potencuara, analizuar në vijim.

13.3. Në analizën financiare për momentin e blerjes së automjetit, e konkretisht periudhën 01.01.2015 - 30.07.2015, Komisioni ka përfshirë si të ardhur të ligjshme shumën 857.923 lekë. Kjo shumë përfaqëson fitimin e realizuar nga bashkëshortja nga aktiviteti, përlllogaritur në mënyrë përpjesëtimore mbi bazën e dokumentacionit të përcjellë nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve²⁰. Ky dokument përcakton të ardhurat e realizuara gjatë vitit 2015, shpenzimet dhe fitimin vjetor në vlerën 1.453.913 lekë. E njëjta vlerë fitimi është konfirmuar edhe nga vetë subjekti në përgjigje të pyetjes nr. 16 të pyetësorit standard nr. 1. Trupi gjykues vlerëson se, llogaritja në mënyrë përpjesëtimore e të ardhurave dhe fitimit nga ana e Komisionit, sikurse përmbledhur më sipër, është e drejtë. Në kushtet që nga dokumentacioni nuk ka të dhëna për fitimin mujor apo fitim të shpërpjesëtuar në pjesën e parë të vitit, dhe që subjekti i rivlerësimit nga ana tjetër, nuk ka depozituar dokumentacion që të vërtetojë përse ka vend të përlllogaritet një mënyrë e ndryshme përlllogaritjeje për shtatë muajt e parë të vitit, mënyra përpjesëtimore e shpërndarjes të të ardhurave, shpenzimeve dhe fitimit, mbetet e vetmja qasje objektive. Për këtë arsye, edhe pretendimi se të ardhurat e realizuara janë më të larta gjatë periudhës janar – korrik 2015, mbetet në nivel deklarativ.

13.4. Subjekti kërkon që të zbriten shpenzimet për transport e hipotekim, pasi përlllogaritja e tyre më vete, përbën dublim në mesin e shpenzimeve të jetesës sipas anketës së buxhetit të familjes, referuar INSTAT për vitin 2014, ku këto zëra përbëjnë respektivisht 6.8% dhe 5.4%. Në përgjigje të këtij pretendimi, trupi gjykues i Kolegjit, në linjë me jurisprudencën²¹ e tij ndër vite, çmon të sjellë në vëmendje që, shpenzimet jetike të llogaritura nga INSTAT, përfshijnë një standard të përbashkët për të gjitha fashat demografike, përfshirë edhe individët me të ardhura modeste. Në

²⁰ Me shkresën nr. {***} prot., datë 12.05.2020.

²¹ Ndër të tjera, vendimi nr. 8 /2021(JR), paragrafi nr. 30, që i përket s. r. I. M.

rrethanat faktike konkrete, ku shpenzimet e transportit²² dhe ato të hipotekës²³ përbëjnë shpenzime specifike, të konfirmuara të kryera nga subjekti, këto zëra nuk mund të argumentohet se përfaqësojnë shpenzimet jetike të llogaritura nga INSTAT, pasi në këto të fundit përfshihen ato shpenzime bazike që kryhen në vijimësi nga çdo shtetas shqiptar, pa përfshirë ato specifike e të veçanta. Për rrjedhojë, këto shpenzime, edhe në vlerësimin e trupit gjykues në Kolegj, nuk mund të zbriten nga analiza financiare e kryer për vitet përkatëse.

II. Të ardhurat nga emigracioni

14. Për disa nga pasuritë e analizuara në vijim, subjekti ka deklaruar si burim, të ardhura nga punësimi si emigrant në Itali në periudhën kohore 1997 – 2000. Nga analiza e akteve në fashikull, nën dritën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim, dhe në linjë me vendime dhe analizën e kryer në çështje të tjera²⁴, trupi gjykues i Kolegjit vëren se, subjekti i rivlerësimit *nuk* arriti të provojë marrëdhënien e punësimit në Itali, qoftë edhe vetëm në aspektin ekzistencial e sasiar të saj. Për pasojë, përjashtohet edhe teorikisht mundësia e provimit të ligjshmërisë së këtyre të ardhurave nën dritën e pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 3, pika 19, të ligjit nr. 84/2016. Edhe në vlerësimin e trupit gjykues të Kolegjit, pretendimet e subjektit për këto të ardhura mbetën në nivel deklarativ dhe me kontradikta në vetvete. Për rrjedhojë, konkluzioni i Komisionit u vlerësua i bazuar. Arsyetimi mbi të cilin mbështetet ky konkluzion, shtjellohet në vijim. Si pasojë e këtij konkluzioni dhe kësaj problematike, afektohen disa nga pasuritë e analizuara në vijim, të cilat janë deklaruar se burojnë nga këto të ardhura.

14.1. Subjekti ka qenë kontradiktor për *sasinë* e të ardhurave të kursyera në sajë të punësimit në Itali. Në deklaratimet e tij ndër vite, krahasuar me ato në procesin e hetimit administrativ, shuma e referuar e këtyre të ardhurave varion nga: tërësisht *e padeklaruar* në deklaratën *vetting*; heshtje në pyetësorin nr. 2; në 60.000 euro (në pyetësorin nr. 4); në rreth 95.000 euro (60.000 euro gjendje *cash* dhe 4.2 milionë lekë për blerjen e një toke dhe kryerjen e një investimi mbi të, në lexim të gërshetuar të deklaratës para fillimit të detyrës dorëzuar në janar 2006 dhe shpjegimeve në ILDKPKI). Së fundmi, ky zë nuk ka *asnjë* vlerë, e shoqërohet me mospërputhje në shpjegimet e dhëna mes janarit e marsit 2016 në ILDKPKI.

14.2. Këto të ardhura të konsiderueshme (ekuivalenti i rreth 30.000 euro në vit sipas deklaratës së parë të pasurisë datë 13.01.2006), përpos që pretendohen në një periudhë qëndrimi *si student*²⁵,

²² Në pyetësorin standard, subjekti ka deklaruar se nga data e emërimit në detyrë, ka qëndruar në shtëpinë e tij në Berat dhe ka udhëtuar çdo ditë drejt vendit të punës dhe anasjelltas, ndërsa në pyetësorin nr. 2, ka deklaruar se transporti për në qytetin e Fierit është realizuar me automjetin e një kolegu, duke ndarë shpenzimet në tri pjesë me pronarin e mjetit dhe një koleg tjetër.

²³ Shuma 110.190 lekë, kryer në datën 30.04.2015.

²⁴ Shih ndër të tjera, vendimet e Kolegjit që i përkasin subjektit të rivlerësimit D. RR., nr. 15/2019 (JR); B. LL., nr. 37/2023 (JR); R. Q., nr. 17/2023 (JR).

²⁵ Aktet e depozituara nga subjekti e konkretisht, leje qëndrimi për studime në emër të tij, lëshuar në datën 04.09.1997 dhe e rinovuar në datën 10.04.2000, dhe deklaratat jo noteriale të dy individëve, të cilët deklarojnë jetesën e përbashkët me subjektin, gjatë periudhës nga shtatori 1997 deri në vitin 2000, provojnë qëndrimin e subjektit në Itali si student, vetëm për periudhën 04.09.1997 – 31.12.2000. Për periudhën përtej kësaj date, subjekti nuk paraqiti të dhëna konkrete e as dokumentacion, mbi kohën, vendin dhe arsyet e qëndrimit, por ka shpjeguar në mënyrë të

nuk rezulton të kenë lënë asnjë gjurmë me dokumentacion, në vitet kur pretendohet të jenë krijuar e sjellë në Shqipëri²⁶. Ndërsa për punësimet në bujqësi apo në agjenci pasurish të paluajtshme, nuk ka asnjë të dhënë qoftë edhe në nivel indicieje - ku dokumenti i vetëm i sjellë prej subjektit që referon punësim, është një shkresë e thjeshtë me probleme të formës e besueshmërisë, pasi i mungojnë aspekte formale të cilat do të forconin besueshmërinë, më së paku²⁷. Kjo shkresë, përpos që daton në nëntor 2021 -- në një fazë të avancuar të hetimit administrativ, me prapësimet e rezultateve të hetimit, referon të ardhura që nuk përputhen në vlerë me deklaratimet e subjektit, sikurse edhe konfirmon që ato nuk përmbushin kriterin e ligjshmërisë²⁸, ndonëse sikurse konstatuar edhe nga Komisioni, legjislacioni italian²⁹ kishte parashikime specifike për detyrimet tatimore që lindin nga punësimi i studentëve.

14.3. Edhe dokumentet e tjera të depozituara nga subjekti, nuk vërtetojnë të ardhura të realizuara nga punësimi në Itali, për të cilat të jenë paguar detyrimet tatimore, në kuptim të pikës 3, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës³⁰. Këto akte provojnë që subjekti ka pasur llogari bankare në emër të tij dhe ka kryer veprime të ndryshme bankare në periudhën nga shtatori 1997 deri në dhjetor 1999, por nuk përmbajnë të dhëna për burimet e krijimit të këtyre fondeve, dhe as referojnë të ardhura nga punësimi apo shlyerje detyrimesh tatimore. Përkundrazi, më së paku, një ndër aktet provon derdhjen/depozitim të një vlere në *cash* nga subjekti / llogarimbajtës. Përpos mungesës së dokumentacionit provues të punësimit të pretenduar, trupi gjykues sjell në vëmendje faktin që vetë

përgjithshme se ka banuar vetëm në Romë, fillimisht në konvikt e më pas në banesa me qira, shpenzim të cilin e ka ndarë me miqtë e tij, por vlera nuk i kujtohet, për shkak të kohës së largët.

²⁶ *Në përgjigje të pyetësorit nr. 4, subjekti ka deklaruar se shuma prej rreth 60.000 euro, e gjeneruar gjatë qëndrimit në Itali, është dërguar pjesë-pjesë nëpërmjet të vëllait. Shumat e sjella nuk janë deklaruar në momentin e hyrjes në territorin shqiptar, pasi ishin nën kufirin e deklarueshëm, prej 10.000 mijë eurosh.*

²⁷ *Me prapësimet kundër rezultateve të hetimit, subjekti ka depozituar një email të znj. B. B., që deklarohet si administratore e vetme e një shoqërie tregtare (“{***}” s. r. l., Romë), sipas të cilit, në periudhën 1997 - 2000, subjekti, student pranë universitetit “{***}”, Romë, ka bashkëpunuar me këtë shoqëri dhe është paguar në shumën 2.000.000 lireta në muaj. Shkresa e thjeshtë, datë 08.11.2021, e znj. B. B., nuk është dokument zyrtar dhe nuk ka asnjë aspekt të dhënash që të jetë konfirmuar për autenticitetin apo për efekt të legalizimit në formën e kërkuar nga ligji.*

²⁸ *E njëjta deklaruese, përmes email-it të datës 01.02.2022, ka konfirmuar mospagimin e detyrimeve tatimore dhe ka pretenduar se, për shkak se leja e qëndrimit ishte për studime, kjo shoqëri e kishte të pamundur punësimin e subjektit sipas rregullave dhe derdhjen detyrimeve fiskale për të gjithë periudhën e punësimit.*

²⁹ *Dekreti i Presidentit të Republikës së Italisë, datë 31.08.1999, nr. 394, neni 14, paragrafi 4, sipas të cilit leja e qëndrimit për studime lejon punësimin për jo më tepër se 20 orë në javë, por nuk përjashton pagesën e detyrimeve tatimore ndaj shtetit. Referuar nga Komisioni në paragrafin 61 të vendimit.*

³⁰ *Konkretisht: (i) Dokumenti, datë 18.06.1998, i bankës “Sanpaolo”, në Torino, referuar taksës 2.500 lireta vërteton vetëm faktin që subjekti ka çelur pranë kësaj banke një depozitë të llojit “me më pak se 10.000.000 lira”, por pa të dhëna konkrete mbi ndonjë shumë të depozituar dhe burimin e saj. (ii) Libreza e kursimeve pranë bankës “Sanpaolo”, në Itali, çelur në datën 18.06.1998, në emër të subjektit, vërteton balancën në këtë datë, në shumën 1.980.000 lira. Referuar përshkrimin që i bëhet në këtë librezë kodeve të veprimeve, rezulton se depozita në shumën 2.000.000 lira nuk ka rrjedhur nga punësimi sikundër pretendohet, por janë pagesa të bëra me para në dorë, origjina e të cilave nuk vërtetohet. (iii) Dokumenti me kod fiskal, datë 12.09.1997, lëshuar nga Zyra e Taksave Romë, nuk përmban të dhëna mbi shumën e të ardhurave që i janë nënshtruar taksimit. (iv) Llogari postare, datë 15.12.1999, për derdhje të shumës 75.000 lira nga subjekti, nuk përmban të dhëna mbi të ardhura të realizuara nga punësimi.*

subjekti ka shpjeguar në ILDKPKI, se arsyeja e pamundësisë së tij për të paraqitur dokumentacion për vërtetimin e të ardhurave, është se *ka punuar në të zezë*.

14.4. Për rrjedhojë, edhe në variantin e fakteve të parashtruara prej tij, në kushtet që subjekti ka qenë i padeklaruar në sistemin tatimor të Republikës së Italisë, trupi gjykues e sheh të pabazuar e të pakuptimtë kërkimin për konsiderimin të ligjshëm për efekt të rivlerësimit të të ardhurave të pretenduara³¹, edhe duke abstraguar nga momenti kohor kur ky punësim u konkretizua për herë të parë apo edhe nga mangësitë e anës formale që ndikojnë në besueshmërinë e përmbajtjes për të ardhurat e pretenduara. Për këtë arsye, trupi gjykues i Kolegjit e vlerëson të pabazuar, edhe këndvështrimin sipas të cilit subjekti i rivlerësimit pretendon, se nuk duhet të penalizohet për mosderdhjen nga punëdhënësi të detyrimeve tatimore, apo se ndodhet në kushtet e pamundësisë objektive për të vërtetuar të ardhurat nga emigracioni, në kuptim të nenit 32, pika 2, të ligjit nr. 84/2016.

14.5. Pamundësia objektive e parashikuar nga kjo dispozitë nënkupton të ardhura, për të cilat aktet janë zhdukur, apo nuk mund të merren sërish – që nënkupton ekzistencën e një dokumentacioni në një moment të caktuar kohor. Në kushtet që subjekti ka pranuar dijeninë e faktit që ishte i padeklaruar, pretendimi se nuk duhet të penalizohet për detyrime të papërmbushura nga punëdhënësi, është i pakuptimtë, në kushtet që këtë mënyrë kompensimi prezumohet ta ketë pranuar vetë. Ky argument merr në konsideratë edhe variantin më të favorshëm e të pretenduar nga subjekti, duke abstraguar nga gjitha aspektet e referuara dhe analizuar më sipër, përse edhe akti i vetëm për të vetmin punësim të konkretizuar nga subjekti, ka probleme besueshmërie.

14.6. Për sa më sipër, trupi gjykues vëren se, ndonëse ka të dhëna që konfirmojnë të drejtën e *qëndrimit* të subjektit në Itali për *studime*, ai nuk ka përmbushur barrën e provës për të provuar marrëdhëniet e punësimit, sasinë e të ardhurave që kanë mundësuar jetesën në periudhën kohore 1997 – 2000, ligjshmërinë e tyre, sikurse as vlerën e konsiderueshme të pretenduar të kursyer e të disponuar deri në vitin 2005. Si rrjedhojë, edhe në analizën e kryer në Kolegji, sikurse në Komision, të ardhurat e pretenduara nga subjekti si emigrant/student në Itali, *nuk* u përfshinë në analizën financiare në funksion të krijimit të pasurive për të cilat ato janë deklaruar si burim.

14.7. Edhe nëse do të abstragohej nga problematika e referuar më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vëren se, sikurse ka arsyetuar Komisioni në paragrafin 63/ii të vendimit, në variantin në të cilin do të përfshiheshin në analizë financiare të ardhurat e deklaruara në shkresën e thjeshtë të sjellë prej subjektit në nëntor 2021, ato gjithsesi do të ishin të pamjaftueshme për të krijuar kursimet, qoftë në vlerën 60.000 euro apo 95.000 euro, apo për të ndryshuar situatën financiare që rezultoi. Konkretisht, subjekti pretendon se në deklaratën para fillimit të detyrës si OPGj, më 13.01.2006, ka deklaruar të ardhura vjetore në vlerën 30.000 euro. Nga llogaritja e kryer nga Komisioni, nën një qëndrim garantist, duke marrë të mirëqenë se ai ka përfituar të ardhura prej 2.000.000 lireta/muaj, për periudhën shtator 1997 – shtator 2000, rezultoi se shuma e të ardhurave të akumuluar *në total* do të ishte në vlerën 74.000.000 lireta ose 38.218 euro. Pas zbritjes së

³¹ Referuar në detaj në poshtëshënimin nr. 27, punësimi në “{***}” s. r. l., dhe aktet e dërguara nga znj. B. B.

shpenzimeve të jetesës, shuma në dispozicion për kursim do të ishte 21.569 euro - e pamjaftueshme për cilëndo nga vlerat e deklaruara për efekt të krijimit të pasurive.

14.8. Më tej, trupi gjykues i Kolegjit vëren se subjekti ka qenë evaziv e i paqartë në vazhdimësi edhe për sa i përket destinacionit të përdorimit të të ardhurave të pretenduara nga emigracioni. Në pyetësonin nr. 4, ai ka deklaruar se ato janë përdorur për të blerë një pasuri tjetër (tokë në {***}) dhe për investimin në një impiant të gazit) ndërsa në deklaratën *vetting*, shpjegimet në ILDKPKI dhe përgjigjet e pyetësorit nr. 2, këto të ardhura janë deklaruar si burim krijimi i një apartamenti të analizuar në vijim. Edhe këto kundërthënie u bënë pjesë e vlerësimit tërësor të aspekteve të ndryshme të mungesës së një versioni të konsoliduar për sasinë, burimin dhe provueshmërinë e të ardhurave në vlerat e konsiderueshme të pretenduara nga subjekti.

14.9. Në vijim të sa më sipër evidentuar, trupi gjykues i Kolegjit çmon të theksojë edhe që pretendimet e subjektit, për qenien në kushte të ngjashme me rrethanat faktike të çështjes “Sevdari kundër Shqipërisë”, janë të pabazuara e nuk qëndrojnë, në secilin këndvështrim të analizuar. *Së pari*, në çështjen “A. Sevdari” objekt diskutimi ishin të ardhura të krijuara nga personi i lidhur/bashkëshorti, dhe jo vetë subjekti, përfshirë edhe për një periudhë kohore përpara se lidhja e tyre të formalizohej. Sikurse arsyetuar nga GjEDNj-ja në çështjen “Sevdari kundër Shqipërisë”, apo edhe nga Kolegji gjatë rishikimit të çështjes³², fondet nga puna në emigrim në rastin e subjektit, pretendohet të jenë krijuar nga vetë subjekti dhe jo nga familjarë të tij, ndryshe nga rasti “Sevdari”, ku të ardhurat ishin realizuar nga bashkëshorti i saj, *para martese*, dhe për më tepër, në një periudhë kur ajo *nuk ishte bërë ende prokurore apo zyrtare publike*. Në rrethanat konkrete, subjekti do të ishte në kushte të ngjashme nëse pretendoheshin pasuri të krijuara prej prindërve të tij nga punësimi jashtë Shqipërisë, gjatë kohës kur ai ishte i mitur ose student. *Së dyti*, në rrethanat e asaj çështje, për të ardhurat e krijuara pas martese, kishte të dhëna të mjaftueshme për punësimin e bashkëshortit të subjektit jashtë Shqipërisë, sikurse edhe kishte gjurmë të padiskutuara të ekzistencës së tyre, për shkak të dërgimit nëpërmjet bankës. Në rastin e subjektit, ka gjurmë vetëm të qëndrimit të tij për studime në Itali, ndërsa jo vetëm që nuk provohet punësimi -- në bujqësi apo në sektorin imobiliar -- por edhe vërehen probleme të besueshmërisë dhe ligjshmërisë të së vetmes marrëdhënie punësimi pranë një shoqërie, paraqitur si provë pas rezultateve të hetimit, dhe konfirmuar nga të dyja palët si punësim për të cilin nuk ka vend të analizohen detyrimet tatimore pasi nuk ka qenë punësim i normuar e rregulluar. *Së treti*, kundërthëniet e subjektit, qoftë për sasinë dhe për përdorimin e fondeve të pretenduara nga puna në emigrim, vënë në dyshim besueshmërinë e tyre. *Së fundmi*, trupi gjykues i Kolegjit e gjen të pabazuar pretendimin e subjektit, për të mos

³² *Shih pikën 25 dhe nën-pikat e vendimit nr. 20, datë 10.05.2024, të Kolegjit, ku përmbledhet arsyetimi i GjEDNj-së mbi të ardhurat nga emigracioni: “Në lidhje me vlerësimin e pasurive, GjEDNj-ja vëren se: të gjitha rastet e mosdeklarimit të mjaftueshëm ose të mosjustifikimit të pasurive për qëllime të nenit 61(3) të Ligjit të Rivlerësimit, të konstatuara nga KPA-ja, kishin lidhje në mënyrë ekskluzive me të ardhurat e fituara nga bashkëshorti i saj nga punësimi jashtë vendit dhe jo me të ardhurat e saj personale. Ajo gjykon se në këto rrethana, është i nevojshëm një kujdes i veçantë për vlerësimin e proporcionalitetit në shkarkimin e saj. [...] Në lidhje me këtë aspekt, GjEDNj-ja ka potencuar se Kolegji ka shqyrtuar të ardhurat që bashkëshorti i ardhshëm i kërkueses i kishte fituar pesëmbëdhjetë-njëzet vjet përpara deklarimit të saj në procesin e rivlerësimit, në një periudhë kur ai nuk ishte martuar ende me të, gjithashtu, sipas kësaj gjykate, i rëndësishëm ishte edhe fakti se kërkuesja nuk ishte bërë ende prokurore apo zyrtare publike e një roli tjetër që t’u nënshtronte ligjeve për deklarimin e pasurive. [...]”.*

bërë pjesë të rivlerësimit periudhën gjatë së cilës ka ushtruar funksionin e OPGj-së. Në kushtet që oficeri i policisë gjyqësore është zyrtar publik i sistemit të drejtësisë, madje edhe subjekt deklarues në vitin 2005, veprimtaria e këtij funksionari është me rëndësi vendimtare, më së paku për aspektin procedural, i cili i shtrin efektet në mënyrë të drejtpërdrejtë në zgjidhjen në themel të çështjes penale. Në linjë me vendime të mëparshme të Kolegjit³³, qoftë për këtë kategori subjektësh apo të tjerë që kanë pasur shkëputje profesionale gjatë karrierës³⁴, kërkesa e subjektit për të përjashtuar nga kontrolli pasuritë e krijuara përpara emërimit në detyrën e prokurorit, u vlerësua e pabazuar.

14.10. Sa më sipër është një qëndrim i elaboruar nga Kolegji për mënyrën sesi ka zbatuar në praktikë pasuritë e deklaruara nga subjektet e rivlerësimit, përfshirë edhe ato për të cilat pretendohet si kohë krijimi përpara marrjes së një funksioni të caktuar. Konkretisht, vendosja e kritereve kohore do të ishte alogjike dhe do të binte ndesh me konceptin e rivlerësimit, i cili për nga natyra nënkupton kontrollin e veprimeve të ndodhura në të shkuarën. Për nga natyra, rivlerësimi është analizë e së shkuarës së një funksionari publik, duke mbajtur në konsideratë që objekt kontrolli është pasuria, dhe për këtë shkak, institucionet e rivlerësimit kontrollojnë burimin (në të shkuarën) për të cilin është krijuar kjo pasuri. Rivlerësimi mund të perkufizohet si vlerësim i integritetit për të përcaktuar përshtatshmërinë për funksione publike. “[...] Integriteti i referohet respektimit nga një funksionar i standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe sjelljes profesionale, përfshirë edhe rregullsinë dhe përshtatshmërinë e situatës financiare [...]”.³⁵

III. Likuiditetet në llogari bankare në datën 31.01.2017 dhe huaja prej 17.000 eurosh

15. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti ka deklaruar llogarinë bankare në emër të tij pranë Raiffeisen Bank, në vlerën 3.300 euro, kursyer nga puna si Oficer i Policisë Gjyqësore (në vijim me shkurtimin OPGj). E njëjta shumë është deklaruar në deklaratën për vitin 2014, pa burim krijimi. Në deklaratën për vitin 2016, shuma në fjalë është deklaruar e krijuar nga kursimet nga paga e tij si OPGj, për periudhën 9 vjet e 6 muaj. Së fundmi, në deklaratën para fillimit të detyrës si prokuror, në vitin 2014, subjekti ka deklaruar një llogari bankare me vlerë 20.000 euro, të krijuar me kursimet nga paga e tij si OPGj, për periudhën 9 vjet e 6 muaj. Po në deklaratën *vetting*, subjekti ka deklaruar edhe një kontratë huaje kundrejt një individi, mik i tij, me specifikim vetëm shifrën “17”. Në kontratën e huas datë 15.02.2015, jonoteriale bashkëlidhur deklaratës *vetting*, shuma e dhënë hua referohet në vlerën 17.000 euro. Ndonëse në gjithë deklaratimet mungojnë të dhënat mbi kthimin e huas, ajo rezulton e pashlyer, më së paku deri në datën 13.10.2019 të vdekjes

³³ Ndër të tjera, në çështjen e subjektit të rivlerësimit S. P. nr. 12/2022 (JR); A. A. 50/2023 (JR).

³⁴ Ndër të tjera, arsyetuar në vendimet e Kolegjit për subjektin e rivlerësimit A. Z., nr. 2/2019 (JR); S. N. 37/2021 (JR); K. G., nr. 8/2023.

³⁵ Vendimi i Kolegjit që i përket subjektit të rivlerësimit Xh. Z., nr. 19/2019 (JR), paragrafi 39 dhe poshtëshënimi 71, <https://www.ohchr.org/Documents/Publications/RuleoflawVettingen.pdf>.

së huamarrësit³⁶. Shuma 20.000 euro është depozituar në bankë pak javë pasi subjekti të emërohej prokuror³⁷.

15.1. Komisioni ka konstatuar se kjo shumë ka shërbyer si burim për krijimin e shumës 3.300 euro gjendje në llogari bankare në deklaratën *vetting*, ashtu edhe për shumën 17.000 euro dhënë hua.³⁸ Përfundimisht, pasi ka dëgjuar shpjegimet e subjektit dhe pranuar disa prej pretendimeve të tij, Komisioni konkludoi se subjekti nuk ka pasur mjaftueshëm të ardhura për të krijuar kursimin në shumën 20.000 euro, e për pasojë, edhe shumën e deklaruar gjendje në deklaratën *vetting*, dhe atë të dhënë hua në vitin 2015.

15.2. Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionet e mësipërme nëpërmjet ankimit, duke përsëritur pretendimet e ngritura në rezultatet e hetimit, me fokus mundësinë që ka pasur për krijimin e depozitës 20.000 euro. Duke konfirmuar qëndrimin e tij në përgjigjet e rezultateve të hetimit administrativ, edhe në ankim subjekti pretendon që në analizën financiare duhet të përfshihen: të ardhurat e realizuara nga puna e subjektit në *emigracion*, të cilat duhen vlerësuar në analogji me qëndrimin e GjEDNj-së në çështjen “Sevdari kundër Shqipërisë”, financimi nga babai i tij i një pjese të shpenzimit të transfertës bankare në emër të një përmbaruesi gjyqësor, sikurse edhe shuma 1.121.714 lekë, e depozituar në llogarinë e vajzës së tij, e cila është dhuruar nga babai i subjektit. Në konkluzion, subjekti pretendon se deklarimi në deklaratën *vetting*, për depozitën 3.300 euro, është i saktë dhe se ai ka pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e shumës 20.000 euro, me efekt mbi dy aspektet e kontrollit objekt i kësaj analize.

15.3. Nga analiza e akteve në fashikull dhe pretendimeve të subjektit, nën dritën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim, trupi gjykues i Kolegjit konstaton që konkluzioni i Komisionit është i bazuar. Subjekti i rivlerësimit rezulton me *mungesë* burimesh financiare të ligjshme në vitin 2014, për *depozitim* e vlerës 20.000 euro cash në bankë, nga e cila rrjedhin dy fondet e sipërcituara. Analiza e burimeve të deklaruara konfirmohet edhe në Kolegji, më së paku në vlerën e përllogaritur nga Komisioni prej (-) 785.830 lekësh. Analiza mbi të cilën bazohet ky konkluzion shtjellohet në vijim.

15.4. Sikurse ka evidentuar Komisioni, subjekti ka pasur mospërputhje në deklaratimet e bëra në lidhje me këtë hua. Kështu, ndërsa në deklaratën për vitin 2014, subjekti ka deklaruar huan me vlerë 20.000 euro dhe si burim, tërheqjen nga depozita në Raiffeisen Bank dhe kursimet nga paga, në deklaratën *vetting* dhe deklaratën për vitin 2016, subjekti ka shtuar si burim edhe ndihmën

³⁶ Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka depozituar edhe një deklaratë të thjeshtë jonoteriale dhe pa datë, të ish-bashkëshortes së të ndjerit B. E., e cila ka pohuar faktin se ka bashkëjetuar me të ndjerin deri në datën e vdekjes 13.10.2019 dhe ka dijeni për kontratën e huas në shumën 17.000 euro, e cila nuk është kthyer edhe aktualisht. Në kushtet ku kjo deklaratë është pa datë, termi “aktualisht” nuk bën sens, megjithatë sipas kësaj deklarate presupozohet që më së paku deri në datën e vdekjes 13.10.2019, kjo hua ishte e pashlyer.

³⁷ Përkatësisht, emëruar më 20.06.2014, ndërsa shuma është depozituar më 4 korrik 2014.

³⁸ Pas çeljes së një depozite me afat 6-mujor në shumën 16.700 euro, subjekti e ka tërhequr atë në datën 15.02.2015, që është edhe data e kontratës së huas, me z. B. E. Për këtë arsye, Komisioni ka konstatuar se kjo shumë e tërhequr është bërë pjesë e huas prej 17.000 eurosh, dhënë hua z. B. E.

financiare nga prindërit, krahas kursimeve nga puna si OPGj. Gjatë hetimit administrativ³⁹, subjekti ka ndryshuar sërish deklarin, duke specifikuar si burim vetëm kursimet e pagës si OPGj, nga viti 2005 deri në vitin 2014, dhe jo më ndihmën financiare nga prindërit.

15.5 Në kuadër të barrës së provës, subjekti kërkoi: (i) përfshirjen në analizë si të ardhur të ligjshme, të shumës 1.500 euro, dhuruar vajzave të subjektit nga gjyshi në vitet 2013 dhe 2014; (ii) përlllogaritjen e shumës 1.911.500 lekë, paguar përmbaruesit në vitin 2013 si derivat i të ardhurave nga emigracioni, dhe pjesa prej 911.500 lekësh si kontribut nga i ati, duke mos e konsideruar si shpenzim këtë zë. Komisioni përfundimisht pranoi kërkimet e subjektit për fondet e dhëna nga i ati, respektivisht në shumat 911.500 lekë dhe 1.500 euro. Nga ana tjetër, nuk u pranua pretendimi për të mos e konsideruar këtë transfertë si shpenzim, ndërsa në kushtet që të ardhurat nga emigracioni nuk u provuan, shuma 1 milion lekë u ngarkua si shpenzim i ekonomisë familjare. Pranimi i pjesshëm i këtyre pretendimeve solli zbutje të balancës negative, por jo përmbysje të rezultatit. Për rrjedhojë, sipas analizës së rishikuar të Komisionit, rezultati financiar për periudhën dhjetor 2005 – 20.06.2014, ka ndryshuar nga (-) 1.904.719 lekë, në (-) 785.830 lekë. Ndonëse është zbutur balanca negative, subjekti rezulton me pamjaftueshmëri të të ardhurave të ligjshme për të krijuar kursimin në shumën 20.000 euro, e për rrjedhojë edhe për huadhënien dhe gjendjen në llogari.

15.6. Në vijim të arsytimit të mësipërm për të ardhurat nga emigracioni, dhe duke abstraguar nga mospërputhjet në shpjegimet e subjektit⁴⁰ gjatë hetimit administrativ -- sipas të cilave, burimi i transfertave në BKT drejt përmbaruesit, kanë qenë ndihma nga prindërit dhe të ardhurat e tij nga paga si OPGj -- vlera 1.000.000 lekë, si pjesë e pagesës ndaj përmbaruesit gjyqësor, u përfshi në analizë si një ndër shpenzimet e kryera nga subjekti. Sikurse referuar më sipër, Komisioni është treguar favorizues gjatë kontrollit të kësaj pasurie. Konkretisht, pavarësisht nga kontradiktat e spikatura ndërmjet deklaratës *vetting* dhe shpjegimeve gjatë hetimit administrativ⁴¹ për burimet që kanë shërbyer për depozitimet në vitin 2013 dhe 2014 në llogarinë e vajzave të subjektit, dhe faktin që transfertat e pagesës në drejtim të përmbaruesit përfaqëson një veprim të kryer nga ai vetë dhe jo i ati, Komisioni ka zbritur nga analiza financiare e subjektit këto vlera [1500 euro dhe 911.500 lekë]. Për rrjedhojë, pretendimet e subjektit në ankim në lidhje me këto vlera, u vlerësuan të pakuptimta. Pavarësisht problematikave që paraqet pranimi i pabazuar i këtyre pretendimeve deklarative, nën dritën e garancive procedurale në ankim, gjatë kontrollit të kryer në Kolegj këto vlera u pranuan pa ia ngarkuar subjektit. Si pasojë e kësaj qasjeje të Kolegjit, konfirmohet balanca negative e reduktuar ndjeshëm nga Komisioni pa asnjë arsytim.

³⁹ Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar se shuma 17.000 euro, e dhënë hua, është tërhequr nga llogaria e tij bankare pranë Raiffeisen Bank, e krijuar nga kursimet nga paga e tij si OPGj, nga viti 2005 deri në vitin 2014.

⁴⁰ Në pyetësorin nr. 4, përgjigja nr. 2.

⁴¹ Në deklaratën *vetting* dhe DIPP-në 2016, dy llogaritë bankare në emër të vajzave të tij, janë deklaruar si të krijuara me fondet e dhuruara nga gjyshërit dhe daja. Ndërsa në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti ka deklaruar se shumata e depozituara janë kursime familjare të subjektit dhe fonde të dhuruara nga prindërit e tij, por për shkak të angazhimeve, këto shuma janë derdhur nga daja i fëmijëve.

IV. Apartamenti në {***}, Vlorë, blerë kundrejt çmimit prej 34.800 eurosh

16. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *vetting*, pronësinë individuale (100%) mbi këtë apartament, të blerë me kursimet e emigrimit në Itali dhe me ndihmën financiare të prindërve si edhe vlerën e referuar më sipër. Pjesë e dokumentacionit të përcjellë në Komision është edhe kontrata e shitjes datë 09.07.2014, me palë blerëse subjektin e rivlerësimit. Çmimi 34.800 euro është likuiduar tërësisht jashtë zyrës noteriale. Komisioni ka konstatuar në rezultatet e hetimit, mungesë burimesh për vlerën e plotë të pasurisë. Ndonëse në vendim nuk ka një konkluzion përfundimtar, prezumohet se mungesa e burimeve është konfirmuar në kushtet që Komisioni shprehet se, pretendimet e subjektit për sasi të ardhurash nga emigracioni në vlerën 95.000 euro, janë të pabesueshme.⁴² Po ashtu, duke konstatuar mospërputhje deklarimesh të burimit të krijimit të pasurisë, meqenëse në deklaratën *vetting* subjekti ka shtuar ndihmën familjare, kundrejt të ardhurave nga emigracioni në deklaratën përpara fillimit të detyrës në vitin 2014, Komisioni ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarime kontradiktore e që nuk përputhen me realitetin, për shkak të mungesës së burimeve, të cilat e vendosin atë në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm dhe të veprimeve që cenojnë besimin e publikut, parashikuar nga pikat 3 dhe 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

16.1. Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e përmbledhur më sipër të Komisionit për këtë pasuri, duke potencuar se çmimi i apartamentit është real. Dyshimet e Komisionit, se kjo pasuri është njësi shërbimi, janë në kundërshtim me dokumentacionin e paraqitur prej tij. Subjekti ka pasur aftësi paguese për blerjen e apartamentit, në pjesën më të madhe me të ardhurat nga emigracioni, të cilat duhet të njihen të ligjshme. Ai nuk mund të penalizohet për detyrime tatimore të papaguara nga punëdhënësi i tij në Itali, 25 vite më parë. Për pjesën e financuar nga prindërit, subjekti e ka pasur të pamundur të saktësojë vlerën e këtij kontributi, për shkak të mosmbajtjes shënime dhe kohës së largët të blerjes së apartamentit. Nuk ka asnjë të dhënë që kjo pasuri është e fshehur dhe në këto kushte, Kolegji duhet të analizojë vlerën e kësaj pasurie, nën dritën e konceptit të dyfishit të pasurisë së ligjshme.

16.2. Në përfundim të kontrollit të kryer në Kolegj, në funksion të pretendimeve të mësipërme të subjektit, nën dritën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se konkluzioni i Komisionit është i bazuar. Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarime *kontradiktore* dhe rezultoi me *mungesë* të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar këtë pasuri. Ky vlerësim mban në konsideratë sa arsyetuar më sipër, lidhur me mosprovimin e sasisë së të ardhurave të krijuara e kursyera nga punësimi i subjektit në Itali, sikurse edhe mospërputhjet e vazhdueshme për burimet e krijimit të kësaj pasurie që rezultojnë nga deklaratimet e subjektit të rivlerësimit. Analiza mbi të cilën u bazua ky konkluzion, shtjellohet në vijim.

16.3. Së pari, pretendimet e ngritura në ankim lidhur me çështjen e çmimit dhe funksionit të kësaj pasurie, janë përsëritje e atyre të ngritura më herët në kuadër të barrës së provës⁴³, të cilat rezultojnë

⁴² Referuar paragrafit 63, pika "iii" e vendimit.

⁴³ Me rezultatet e hetimit, subjektit iu kalua barra e provës në lidhje me dyshimin se apartamenti objekt vlerësimi dyshohet të jetë njësi shërbimi, dhe jo apartament banimi, referuar disa rrethanave të rezultuara sikurse janë: (i)

të pranuar nga Komisioni⁴⁴. Për rrjedhojë, këto pretendime çmohen të panevojshme për t'u shqyrtuar në Kolegj, në kushtet që subjekti nuk është ngarkuar me përgjegjësi disiplinore për këto gjetje të mbetura deri në nivelin e konstatimit paraprak.

16.4. Nga ana tjetër, qëndrimi *kontradiktor* i subjektit lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie, konfirmohet edhe nga analiza e akteve në fashikull, kryer nga trupi gjykues i Kolegjit. Konkretisht, dhe sikurse ka konstatuar Komisioni, në deklaratën përpara fillimit të detyrës si prokuror (hartuar në korrik 2014), si burim për apartamentin janë deklaruar vetëm kursimet *nga emigracioni*, ndërsa në deklaratën *vetting*, subjekti ka shtuar edhe ndihmën financiare nga prindërit, pa përcaktuar ndonjë vlerë. Teksa gjatë hetimit administrativ⁴⁵, subjekti ka zgjedhur të *heshtë* për kontributin financiar të prindërve në nivel sasior dhe burimin që ka gjeneruar këtë financim, në prapësimet kundër rezultateve të hetimit dhe në ankim, subjekti ka pretenduar në mënyrë të *përgjithshme* - pa e konkretizuar me detaje e dokumentacion - se për blerjen e këtij apartamenti kanë shërbyer në pjesën *më të madhe* të ardhurat nga punësimi në emigracion, ndërsa një pjesë më e vogël është financuar nga prindërit, në një vlerë të papërcaktueshme, “pasi nuk ka shënime dhe ka kaluar kohë e gjatë”.

16.5. Në përmbledhje dhe si konkluzion i këtyre ndryshimeve të pohimeve e shpjegimeve të subjektit, trupi gjykues i Kolegjit çmon se, i vetmi burim që mund t'i nënshtrohet kontrollit, janë të ardhurat e pretenduara nga puna në emigracion, të cilat mbeten burimi më konsistent i deklaruar përgjatë gjithë fazave dhe deklarimeve, por edhe sepse subjekti e ka pamundësuar analizën e mundësisë së prindërve për të dhënë “ndihmesë”, duke mos dhënë asnjë vlerë apo burim të krijimit të të ardhurave, sikurse as ka treguar përqindjen e këtij kontributi kundrejt krijimit të pasurisë objekt analize. Nga kontrolli i ushtruar analizës financiare të Komisionit, në konsideratë të konkluzioneve të mësipërme mbi burimet e deklaruara, subjekti rezultoi edhe në Kolegj me *pamjaftueshmëri* burimesh të ligjshme, për blerjen e apartamentit objekt kontrolli, në vlerën (-) 4.874.894 lekë / (-) 34.800 euro.

16.6. Bazuar në balancën negative të rezultuar për këtë pasuri, dhe në vijim të arsytimit të mësipërm për deklarime kontradiktore, qoftë për *sasinë* e të ardhurave të kursyera në sajë të punësimit në Itali, apo edhe të *përdorimit* të tyre, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se shtimi si burim, i ndihmesës familjare në deklaratën *vetting*, duket të jetë kryer për të anashkaluar në mënyrë të përgjithshme e pa shifra specifike e kushtëzuese, mungesën e të ardhurave nga emigracioni. Konkretisht, pas hyrjes në fuqi të kuadrit ligjor e nënligjor të rivlerësimit, subjekti duhet të jetë ndërgjegjësuar për nevojën e të provuarit me dokumentacion të të ardhurave, që deri në atë moment ishin pohuar me pretendime thjesht deklarative. Nën dritën e nenit 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, dhe Udhëzimit të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së nr. 4095/2016, subjektet duhet të

çmimi i blerjes së këtij apartamenti është 2.9 herë më i lartë se ai i referencës të EKB-së; (ii) nga fotografitë e objektit, apartamenti duket i pozicionuar në zonën e njërive të shërbimit të këtij objekti, dhe jo në zonën e apartamenteve të banimit; (iii) ky apartament nuk është përdorur si apartament banimi nga ana e subjektit.

⁴⁴ Në pikën 58 të vendimit objekt shqyrtimi, Komisioni ka vlerësuar përfundimisht se nuk u vërtetua që kjo pasuri të jetë blerë si një njësi shërbimi dhe u vërtetua që kjo pasuri nuk është përdorur nga ana e subjektit.

⁴⁵ Në pyetësin nr. 2, Komisioni i ka kërkuar subjektit të shpjegojë dhe provojë shumat e paguara nga prindërit dhe burimin e tyre.

sillnin dokumentacion për të provuar ligjshmërinë e burimeve të krijimit të pasurive që deklaroheshin, përfshirë edhe të ardhurat nga punësimi në emigracion.

16.7. Po ashtu, në kushtet që edhe në Kolegj u konfirmua pamjaftueshmëria financiare e burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, trupi gjykues e gjen të pabazuar pretendimin e subjektit për ta kanalizuar arsyetimin dhe vlerën e kësaj pasurie nën dritën e konceptit të dyfishit të pasurisë së ligjshme, meqenëse nuk rezultoi e fshehur. Sikurse arsyetuar më lart, në pikën 12.4 të këtij vendimi, trupi gjykues rikonfirmon edhe në këtë rast, qëndrimin në jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit, i cili e ka ezauruar mjaftueshëm këtë aspekt.

16.8. Në përmbyllje të arsyetimit të bërë për këtë apartament, trupi gjykues i Kolegjit vëren se subjekti i rivlerësimit dështoi të provojë punësimin në Itali, e për pasojë, edhe të ardhurat e fituara gjatë kohës që studionte, duke përjashtuar edhe teorikisht provueshmërinë për ligjshmërinë e tyre në kuptim të pikës 3, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë vlerëson për këtë pasuri, se subjekti ndodhet në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm, në kuptim të germës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016. Ndërsa deklaratimet kontradiktore në lidhje me burimet e pasurisë, u analizuan në drejtim të besueshmërisë së tij në tërësi për mënyrën e krijimit të pasurive dhe në pikën fundore, për kriterin e vlerësimit të pasurisë, sipas nenit 59, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, dhe si tregues i mungesës së transparencës gjatë procesit të hetimit administrativ, në vlerësimin tërësor të çështjes, në përputhje me parashikimin e nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

V. Gjendje e likuiditeteve jashtë sistemit bankar, në shumën 1.500.000 lekë

17. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti ka deklaruar një “gjendje *cash*” në shtëpi, në shumën 1.5 milionë lekë, krijuar nga një shumë prej 500.000 lekësh, e përfituar nga shitja e një toke në fshatin {***}, Tiranë, në vitin 2006, dhe nga shuma 1 milion lekë me burim kursimet nga emigrimi. Komisioni konkludoi se subjekti nuk arriti të kundërshtojë barrën e provës në lidhje me likuiditetin me vlerë 1.500.000 lekë, dhe se ka kryer deklarime kontradiktore për burimin e të ardhurave, duke u ndodhur në kushtet e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Komisioni mbërriti në këtë vlerësim bazuar në konkluzionet si vijon: (i) subjekti nuk ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e këtij likuiditeti; (ii) ka mospërputhje në deklarime në lidhje me burimet e të ardhurave që kanë shërbyer për krijimin e pjesës përbërëse të likuiditetit *cash* në shumën prej 1.000.000 lekësh, pasi në deklaratën *vetting*, subjekti ka deklaruar të ardhura të kursyera nga emigrimi në Itali, ndërsa në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ka deklaruar të ardhura nga shitja e tokës në {***}, Tiranë, dhe nga kursimet e pagës si OPGj.

17.1. Përpos argumenteve të përmbledhura e arsyetuara më sipër për të ardhurat nga punësimi në emigracion, për këtë konkluzion subjekti shprehet edhe që ka deklaruar saktë burimin e krijimit të kësaj shume, dhe që shpjegimi gjatë hetimit administrativ, ku ka dhënë të ardhurat nga puna si OPGj, si burim për këtë pasuri, nuk duhej vlerësuar si deklarim kontradiktor, por si pasaktësi pa pasojë për të, në përputhje me jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit për pasaktësitë në deklarime kur ato nuk shoqërohen me pamjaftueshmëri financiare. Gjendja *cash* objekt kontrolli, është krijuar përpara fillimit të detyrës së prokurorit, ndërkohë që ai është bërë subjekt deklarues

në vitin 2014. Nuk ka pasur mundësi të deklarojë burimin e krijimit në deklaratat periodike të pasurisë. Komisioni duhet të kishte kryer analizën financiare të ndarë veçmas për pasuritë e krijuara para dhe pas fillimit të detyrës.

17.2. Nga kontrolli i analizës financiare në funksion të shkaqeve të mësipërme të ankimit, subjekti i rivlerësimit rezulton edhe në Kolegj, me mungesë burimesh financiare të ligjshme për të krijuar këtë pasuri *me burimet e deklaruar* në deklaratën *vetting*. Sikurse referuar më sipër për problematikën e të ardhurave nga emigracioni, nga kontrolli i ushtruar analizës financiare, subjekti gjendet në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, *minimalisht* për shumën e referuar me burim të ardhurat nga *emigracioni*. Edhe për këtë pasuri, u konstatuan deklarime *kontradiktore* lidhur me burimin e krijimit në deklaratimet ndër vite dhe deklaratën *vetting*. Në vijim, arsyetimi i Kolegjit, mbi të cilin u bazua vlerësimi i mësipërm.

17.3. Fillimisht, trupi gjykues i Kolegjit vëren se, kërkimi i subjektit për ta konsideruar mungesën e koherencës për burimet e krijimit të kësaj pasurie si deklarim të pasaktë e pa pasojë, është i pabazuar. Ndërsa në deklaratën *vetting*, deklaratën para fillimit të detyrës të vitit 2014, dhe atë periodike të vitit 2016, konfirmohen të njëjtët burime për gjendjen *cash* – referuar në krye të kësaj rubrike – gjatë kontrollit të ushtruar nga ILDKPKI-ja në janar 2016, subjekti ka referuar burime të tjera, por jo përfitimin nga shitja e tokës⁴⁶. Në vijim, gjatë hetimit administrativ në Komision⁴⁷, të ardhurat nga emigracioni nuk përmenden më si burim, duke u zëvendësuar me dy burime të tjera e konkretisht: (i) me kursimet e pagës si OPGj -- në kundërshtim me deklarime të mëparshme, se kursimet nga paga si OPGj kanë shërbyer për shumën 20.000 euro, të depozituar në datën 04.07.2014 në Raiffeisen Bank dhe (ii) me të ardhurat nga shitja e tokës në {***}. Këto të fundit, në deklaratimet e mëparshme ishin deklaruar një ndër burimet për gjendjen *cash* prej 1.5 milionë lekësh, dhe jo për shumën 1 milion lekë të pretenduar më herët si e krijuar vetëm me të ardhurat nga emigracioni.

17.4. Nga gjithë këto devijime e ndryshime të burimeve që parashtron subjekti, dhe versione të ndryshme të ardhurash të disponuara prej tij, trupi gjykues vëren se subjekti paraqet probleme të spikatura besueshmërie, që përveç të tjerash, pamundësojnë ushtrimin e kontrollit të pasurisë. Për rrjedhojë, pretendimet e tij me objekt relativizimin e peshës së secilit zigzag të versioneve të mënyrës/burimeve të krijimit të secilës pasuri, është e pamundur të cilësohen si pasaktësi pa efekt, apo që materializohen vetëm në procesin e hetimit administrativ, e si të tilla, nuk duhet të shoqërohen me pasojë. Sa më sipër, pretendimi i subjektit në drejtim të saktësisë së deklarimeve, u vlerësua i pabazuar.

17.5. Në vijim të arsyetimit të mësipërm, mbi kontradiktat në deklarime dhe për të ardhurat nga puna si OPGj, si burim krijimi për depozitën 20.000 euro (trajtuar më lart), dhe jo për këtë likuiditet gjendje, trupi gjykues i Kolegjit, për efekt të kontrollit të analizës financiare, u bazua në dy burimet e deklaruar në deklaratën *vetting*. Në vijim të këtij qëndrimi, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se, nën dritën e arsyetimit të mësipërm për të ardhurat nga punësimi në emigracion – që në këtë

⁴⁶ Në procesverbalin datë 27.01.2016, mbajtur në ILDKPKI, subjekti shpjegon se si burime të krijimit të kësaj gjendje *cash* kanë shërbyer të ardhurat nga emigracioni dhe kursime të ndryshme, por pa specifikuar me vlera konkrete.

⁴⁷ Në përgjigje të pyetësorit nr. 2.

pasuri kanë efekt mbi vlerën 1 milion lekë – shuma e mbetur prej 500.000 lekësh nga shitja e tokës, edhe në alternativën që do të konsiderohej burim i ligjshëm [analizuar edhe në vijim], do të ishte e pamjaftueshme për të justifikuar shumën e deklaruar kursim prej 1.5 milionë lekësh në deklaratën *vetting*. Së fundmi, trupi gjykues e gjen të drejtë arsyetimin e Komisionit, në pikën 74 të vendimit, se pavarësisht se burimi i likuiditetit në *cash*, prej 1.500.000 lekë, është deklaruar me të ardhura nga emigracioni, përpara se subjekti të fillonte detyrën e prokurorit, në kushtet që ky likuiditet është mbartur që nga viti 2005 apo në vijim, deri në 2006, kur u shit pasuria në {***}, Tiranë, deri në vitin 2014 (vite në të cilat subjekti ka qenë OPGj), si dhe në vijim, deri në deklaratën *vetting*, për të hequr çdo dyshim që ky likuiditet mund të jetë krijuar me të ardhura të paligjshme gjatë ushtrimit të detyrës dhe sipas parashikimeve të pikës 3, nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, subjekti duhet të vërtetonte burimin e ligjshëm të të ardhurave.

17.6. Sa më sipër, trupi gjykues mban në konsideratë *pamjaftueshmërinë* e burimeve të ligjshme të subjektit për *blerjen* e kësaj toke në vitin 2005⁴⁸ dhe efektin financiar që passjell mbi ligjshmërinë e të ardhurave të përfituara në vijim nga shitja e së njëjtës tokë. Në kushtet që mbeti i paprovuar i vetmi burim i deklaruar për *blerjen* e tokës⁴⁹, të ardhurat nga punësimi në emigracion, trupi gjykues i Kolegjit, njëjtë si Komisioni, e vlerëson të pajustificuar ligjërisht shumën 4 milionë lekë, të shpenzuar për *blerjen* e tokës, e për rrjedhojë edhe shumën prej 500.000 lekësh të përfituar nga shitja e saj, parë nën efektin zinxhir që prodhon pamjaftueshmëria e burimeve të ligjshme në momentin e krijimit. Në këto rrethana, trupi gjykues e vlerëson të drejtë qëndrimin e Komisionit për të mos e përfshirë shumën 500.000 lekë nga shitja e tokës, si të ardhur të ligjshme në analizën e pasurisë “gjendje *cash*” prej 1.500.000 lekësh, objekt vlerësimi. Megjithatë, sikurse arsyetuar edhe më sipër, edhe nëse abstragohet nga gjithë problematika e provueshmërisë së të ardhurave nga emigracioni në nivel sasior, ligjshmërie dhe ekzistencës së tyre, apo mungesës së dokumentacionit që provon mënyrën se si subjekti e përfitoi këtë pasuri apo kontradiktat për çfarë ndodhi me investimin, e ruajtjen të ngurtësuar të kësaj shume, deri në janar 2017 me deklaratën *vetting*, shuma 500.000 lekë nga shitja e tokës, është e pamjaftueshme për të mbuluar vlerën e likuiditeteve të deklaruara në deklaratën *vetting*.

17.7. Trupi gjykues i Kolegjit, për efekt të analizës financiare, e vlerësoi të drejtë pretendimin e subjektit se analiza për këtë pasuri duhet të kryhej për periudhën *deri para datës 20.06.2014*. Komisioni ia ka ngarkuar pasaktësisht subjektit kursimet *cash* në vlerën 1.500.000 lekë, në analizën e periudhës 20.06.2014 – 31.12.2014, pa marrë në konsideratë faktin që kjo gjendje *cash* nuk është deklaruar si e krijuar gjatë kësaj periudhe dhe as me burim të ardhurat⁵⁰ e specifikuar

⁴⁸ Subjekti ka shitur këtë tokë me sipërfaqe 1000 m², me kontratën noteriale të datës 22.06.2006, në vlerën 500.000 lekë. Referuar deklaramit të subjektit në deklaratën periodike për vitin 2006, rezulton se ai nuk ka kontratë për përfitimin e kësaj pasurie apo për të provuar pagesën e deklaruar në vlerën 4.000.000 lekë, që sipas subjektit ka ndodhur në një datë të papërcaktuar në vitin 2005. Investimi është kryer për të ndërtuar një impiant gazi, investim në të cilin subjekti ka deklaruar së ishte aksionar me 50% me huamarrësin e analizuar më sipër, z. B. E.

⁴⁹ Në deklaratën para fillimit të detyrës si OPGj, të dorëzuar në datën 13.01.2006, subjekti nuk ka specifikuar ndonjë burim, ndërsa në ILDKPKI, në janar dhe mars 2016, sikurse edhe në ankim, subjekti deklaroi se kjo tokë është blerë me të ardhurat e realizuara në periudhën shtator 1997 – prill/maj 2000, nga emigracioni.

⁵⁰ Në analizën financiare të kryer për këtë pasuri, Komisioni ka përfshirë si të ardhura: pagat e subjektit dhe të bashkëshortes, fitimin e bashkëshortes nga noteria dhe të ardhurat nga interesat bankarë.

në analizën e Komisionit. Për më tepër, Komisioni ia ngarkon dy herë këtë vlerë subjektit, duke e konsideruar njëkohësisht, edhe si shtesë të likuiditeteve, edhe si shpenzim⁵¹. Ndonëse u gjet i drejtë, ky pretendim nuk e përmbys rezultatin financiar për periudhën deri para datës 20.06.2014 të krijimit të kësaj pasurie.

17.8. Bazuar në sa më lart analizuar, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se subjekti gjendet në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, qoftë për gjithë këtë vlerë, apo edhe në versionin që mban në konsideratë *minimalisht* shumën e pretenduar nga të ardhurat nga punësimi në emigracion. Deklarimet kontradiktore për burimin e krijimit të pasurisë në fjalë, sikurse edhe për pasurinë e analizuar më sipër, u bënë pjesë e vlerësimit të besueshmërisë së subjektit në kontrollin e kriterit të pasurisë, dhe si mungesë e transparencës së treguar prej tij gjatë procesit të hetimit administrativ, në vlerësimin tërësor të çështjes, në përputhje me parashikimin e nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

VI. Veprimtaria tregtare e impiantit të gazit

18. Gjatë hetimit administrativ, Komisionit i rezultuan të dhëna që provojnë se subjekti kishte vendosur të krijonte një aktivitet tregtar, i cili ka kaluar edhe në procedura regjistrimi fillimisht. Më pas është hequr dorë nga kjo shoqëri. Në pikën 71, nënpika iv, të vendimit objekt ankimi, Komisioni ka arsyetuar se nuk mund të arrijë në konkluzionin që subjekti ka ushtruar veprimtari në kundërshtim me ligjin. Mosdhënia e shpjegimeve dhe dokumenteve për disa rrethana të kërkuara në kuadër të barrës së provës, ndryshimi i deklarimeve në lidhje me regjistrimin e shoqërisë tregtare, si dhe mungesa e deklarimeve për qartësimin e identitetit të një personi me të cilin është ngritur ky aktivitet, u vlerësuan nga Komisioni në kuadër të cenimit të besimit të publikut.

18.1. Subjekti i kërkon Kolegjit të konstatojë të padrejtë vlerësimin e Komisionit, pasi nuk ka kryer veprimtari private gjatë ushtrimit të detyrës si prokuror, referuar akteve ligjore e nënligjore që rregullojnë statusin, etikën dhe konfliktin e interesit. Këtë e vërtetojnë aktet nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

18.2. Trupi gjykues i Kolegjit konstaton se, nga aktet në fashikull, rezultojnë indicie se subjekti ka ndërmarrë hapa për krijimin e një veprimtarie tregtare. Megjithatë, në kushtet që nga aktet është e pamundur të konkludohet ekzaktësisht koha kur disa nga këto veprime janë kryer, në raport me marrjen e detyrës prej tij si OPGJ, këto indicie mbeten të pamjaftueshme për të konkluduar që subjekti ka ushtruar veprimtari private në kundërshtim me ligjin, e në pikën fundore, jo përcaktuese për efekt të vendimmarrjes. Pavarësisht nga ky konkluzion, trupi gjykues vëren mungesë sinjoreteti të subjektit, të shprehur qoftë në formën e mungesës së deklarimeve apo ndryshimit të tyre, ashtu edhe në mosdhënien e shpjegimeve për disa rrethana me rëndësi për hetimin. Kjo sjellje u mbajt në konsideratë në drejtim të konstatimit për cenim të besimit të publikut, në vlerësimin tërësor të çështjes. Arsyetimi mbi të cilin bazohet ky konkluzion shtjellohet në vijim.

⁵¹ Në zërin “Sistemim veprimi për burimin e paligjshëm për gjendjen cash 1.500.000 lekë”.

18.3. Kjo veprimtari tregtare rezulton të jetë deklaruar vetëm në deklaratën për herë të parë të vitit 2005, të cilën subjekti e ka plotësuar për shkak të emërimit si OPGj. Në atë formular, subjekti ka deklaruar se, mbi sipërfaqen e tokës 1000 m², me adresë në {***}, Tiranë, ndodhet edhe një objekt i papërfunduar, me sipërfaqe 100 m², në të cilin do të ngrihet një impiant gazi, veprimtaria tregtare e të cilit është në regjistrim e sipër në gjykatë. Ai deklaron se në këtë veprimtari, është aksionar me 50%, së bashku me një person të quajtur “{***}”. Subjekti nuk jep mbiemër për këtë individ.

18.4. Komisioni konstatoi kontradikta në deklaratimet e subjektit. Fillimisht, subjekti ka shpjeguar⁵² që impianti i gazit nuk u ndërtua dhe regjistrimi i shoqërisë në gjykatë nuk u realizua, për shkak të heqjes dorë nga ky biznes. Ai nuk ka dhënë shpjegime për pyetjet që i janë parashtruar në lidhje me fatin e aksioneve të tij të deklaruara më herët, arsyet dhe mënyrën e largimit nga kompania, dhe as për identitetin e plotë të individit me emrin B., për të cilin deklaroi se “nuk i kujtohej mbiemri”. Në vijim të hetimit administrativ,⁵³ subjekti është shprehur se shoqëria është regjistruar, por nuk ka funksionuar asnjëherë për shkak të mosmarrëveshjeve ndërmjet aksionarëve. Në të njëjtin pyetësor, i pyetur në lidhje me dy transfertat në një vlerë thuhet 2 milionë lekë, në vitin 2013, të kryera prej tij në favor të një përmbaruesi⁵⁴, subjekti është shprehur se ato kanë shërbyer për pagimin e detyrimeve të tij (subjektit) kundrejt aksionares tjetër të shoqërisë që donte të krijonte, shuma të cilat ajo i pretendonte kundrejt subjektit.

18.5. Nga sa më sipër, rezulton qartë që, teksa rikonfirmon cilësinë e tij si aksionar në këtë shoqëri, subjekti ka vijuar të heshtë për detaje kyçe, sikurse: historiku i krijimit të aktivitetit, dinamika e kontributit të tij në formë aksionesh, identiteti i ortakut/es, apo pyetjet e tjera, duke krijuar edhe përshtypjen se aksionar/e ishte një grua, në kundërshtim me deklaratimet e mëparshme ku referon si aksionar, një individ të gjinisë mashkull, të quajtur B. Për më tepër, pretendimi se nuk i kujtohej mbiemri i aksionarit tjetër, është haptazi i pavërtetë. Në kushtet që procedurat përmbarimore kryhen mbi bazë dokumentesh, është e pamundur që subjekti të ketë kryer transfertat parash në emër të përmbaruesit për llogari të një kreditori -- që në këtë rast ishte aksionari tjetër -- pa ditur gjeneralitetet e këtij të fundit. Së fundmi, pretendimi se nuk i kujtohet mbiemri i aksionarit B., duket i pasinqertë nëse mbajmë në konsideratë ngjashmërinë e emrit të këtij personi me atë të individit B. E., të cilit subjekti ka pretenduar së i ka dhënë një hua në vlerën 17.000 euro, të pashlyer deri më së paku në vitin 2019, sikurse rezulton nga arsyetimi i pasurisë së parë në këtë vendim.

18.6. Shpjegimet kontradiktore e jobindëse, dhe mungesa e përgjigjeve për sa i është kërkuar, duken si një përpjekje e subjektit për t’iu shmangur hetimit administrativ dhe mungesë bashkëpunimi. Duke mbajtur në konsideratë faktin se që në nisje të procesit të rivlerësimit (me dërgimin e pyetësorit standard, por edhe në komunikime të tjera), subjektit i është bërë me dije rëndësia e bashkëpunimit dhe e mirëbesimit e transparencës që nevojitet gjatë rivlerësimit, dhe ndikimi i tyre në marrjen e vendimit në kuptim të nenit 48, të ligjit nr. 84/2016, nuk mund të argumentohet se subjekti nuk ka qenë në dijeni të rëndësisë ka pasur që në nisje, roli i

⁵² Në përgjigje të pyetësorit nr. 2.

⁵³ Në përgjigje të pyetësorit nr. 4.

⁵⁴ Analizuar më sipër për efektin financiar tek apartamenti në {***}.

bashkëpunimit të tij në procesin e rivlerësimit. Mosdhënia e përgjigjeve për sa i është kërkuar, duke vështirësuar hetimin në këtë drejtim, përgjigjet e përcipta të përfaqësues së tij në seancë dëgjimore, dhe mbi të gjitha, fokusimi i ankimit vetëm në atë që referojnë institucionet për këtë veprimtari, duke anashkaluar veprimet e referuara më sipër, duken si një përpjekje e momentit për t'iu larguar thelbit të pyetjeve.

VII. Analiza financiare

19. Sikurse arsyetuar në pikën 100 të vendimit objekt shqyrtimi, në bazë të rezultatit financiar për periudhën para fillimit të detyrës, Komisioni konstatoi se subjekti i rivlerësimit nuk justifikoi me të ardhura të ligjshme blerjen e apartamentit në {***}, Vlorë, në shumën 4.822.354 lekë, apo 34.800 euro. Ndërsa për periudhën e rivlerësimit (nga data 20.06.2014 e emërimit në detyrë deri më 31.12.2016), subjekti rezultoi me balancë negative në vlerën 5.560.824 lekë. Sipas Komisionit, edhe në variantin garantist, të konsiderimit si të krijuar me burime të ligjshme të shumave 20.000 euro dhe 1.5 milionë lekë,⁵⁵ balanca negative për periudhën e rivlerësimit do të rezultonte në shumën 2.175.219 lekë, e cila do të përbënte shkak për penalizim të subjektit të rivlerësimit.

19.1. Subjekti kundërshton konkluzionin e mësipërm, me pretendimin se është rrjedhojë e metodologjisë së gabuar të Komisionit, pasi nuk ka pranuar të ardhurat e përfituara nga puna e tij në emigracion, kontributin financiar të babait të tij për një pjesë të transfertës në BKT në favor të përmbaruesit, si edhe për shkak të analizës së kryer për pasuritë e krijuara përpara fillimit të detyrës. Gjetjet për këtë kriter, argumenton ai, nuk mund të përbëjnë shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, nën dritën e parimit për deklarim të dyfishit të pasurisë së ligjshme, sipas përcaktimit të nenit D, pika 3, e Aneksit të Kushtetutës.

19.2. Nga kontrolli i analizës financiare të Komisionit, në funksion të shkaqeve të ankimit, subjekti i rivlerësimit rezulton edhe në Kolegj, me balancë negative të analizës financiare, që më së paku konfirmon atë të konstatuar nga Komisioni. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit rezulton me *mungesë* burimesh të ligjshme, sipas përcaktimeve të nenit 33, pika 5, germa “b”, e ligjit nr. 84/2016. Nga analiza financiare e kryer në Kolegj, subjekti rezultoi me balancat negative dhe pamundësi financiare për të krijuar pasuritë: (i) apartament në {***}, në vlerën (-) 4.874.894 lekë / (-) 34.800 euro; (ii) për depozitim e shumës 20.000 euro në datën 04.07.2014, deklaruar në deklaratën *vetting* në pjesët e saj përbërëse prej 3.000 euro dhe huan z. E., për, më së paku në vlerën (-) 785.830 lekë; (iii) mungesë të burimeve financiare të ligjshme në vlerën (-) 91.243 lekë për blerjen e automjetit në datën 30.07.2015 dhe (v) për kursimet *cash* deklaruar në deklaratën *vetting*, në vlerën (-) 1.500.000 lekë.

19.3. Në lidhje me pretendimet me fokus proporcionalitetin e të ardhurave nga emigracioni, konceptin e dyfishit të pasurisë dhe vlerësimin e subjektit vetëm për periudhën pas emërimit në detyrë, trupi gjykues rikonfirmon qëndrimin në jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit, i cili i ka

⁵⁵ Respektivisht, shuma e depozituar pranë Raiffeisen Bank dhe gjendja cash, trajtuar gjerësisht në këtë vendim të Kolegjit.

ezauruar mjaftueshëm këto aspekte, sikurse është arsyetuar gjerësisht më lart, në pikat 12.3 dhe 12.4 të këtij vendimi, për të mos rënë në përsëritje.

20. Në konkluzion të vlerësimit të kriterit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, trupi gjykues i Kolegjit çmon se konkluzioni i Komisionit është i drejtë. Subjekti i rivlerësimit *ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme*, për të justifikuar realizimin e pasurive të deklaruara dhe njëkohësisht kryerjen e shpenzimeve ndër vite. Këto rrethana e vendosin subjektin e rivlerësimit në kushtet e *deklarimit të pamjaftueshëm* për kriterin e vlerësimit të pasurisë, sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, me pasojë aplikimin e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra. Problematikat e tjera që shoqëruan verifikimin e kriterit të pasurisë, e konkretisht, deklaratimet e pasakta dhe kontradiktore, mosdhënia e përgjigjeve apo shpjegimeve për fakte të rezultuara gjatë hetimit të kriterit të pasurisë, në linjë me qëndrime të mëparshme të Kolegjit,⁵⁶ u vlerësuan se ndikojnë në arritjen e konkluzionit përfundimtar për besueshmërinë e subjektit të rivlerësimit, në vlerësimin tërësor të çështjes, me pasojë aplikimin e nenit 61, pika 5, të ligjit nr. 84/2016.

B.3. Analiza e shkaqeve të ankimit që lidhen me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale dhe me vlerësimin tërësor

21. Komisioni e ka vlerësuar subjektin e rivlerësimit “të papërshtatshëm” profesionalisht, dhe se ai ka treguar cilësi të papranueshme në punë, pasi ka kryer hetime të dobëta dhe nuk ka respektuar të drejtat e pjesëmarrësve në proceset penale të verifikuara, kryesisht për shkak të zgjatjes në mënyrë të përsëritur dhe të pajustificuar të hetimeve. Ndërsa, qëndrimi i subjektit në lidhje me çdo konstatim të Komisionit, qëndrimet në lidhje me mungesën e përgjigjeve dhe mosvënien në dispozicion të dokumentacionit nga dosjet penale të kërkuara, janë vlerësuar nga Komisioni si elemente që cenojnë besimin e tij në publik, si pjesë e sistemit të drejtësisë, dhe është mbajtur në konsideratë në vlerësimin tërësor të çështjes.

21.1. Subjekti kundërshton konkluzionin e Komisionit edhe sa i përket vlerësimit në tërësi. Ai argumenton se: (a) Komisioni ka shtrirë hetimin për çështje penale jashtë periudhës së rivlerësimit të përcaktuar në ligjin nr. 84/2016; (b) Vlerësimi i papërshtatshëm është në kundërshtim me raportin e KLP-së dhe dokumentacionin sipas të cilit nuk rezultuan në ngarkim të subjektit masa disiplinore e as materiale hetimore apo procedime penale; (c) Komisioni ka shkelur nenin 6 të KEDNj-së pasi ka vendosur shkarkimin e subjektit për veprime apo mosveprime për të cilat nuk i ka kaluar barrë prove. E vetmja barrë prove i përkiste një çështjeje të hetuar jashtë periudhës së rivlerësimit; (ç) Edhe ndonjë gabim i konstatuar, nuk përbën në asnjë rast shkelje të rëndë, pasi mund t’i ndodhë në rrethana normale çdo magjistrati me nivel mesatar; (d) Subjekti nuk ndodhet në kushtet e pikës 5, të nenit E të Aneksit të Kushtetutës pasi nuk ka kryer veprime që kanë penguar e vështirësuar procesin e rivlerësimit të aftësive profesionale. Komisioni ka interpretuar gabim këtë dispozitë e cila me “pengim apo vështirësim të vlerësimit” ka parasysh veprime konkrete dhe jo mosdhënien e shpjegimeve sipas interpretimit të Komisionit. Nga ana tjetër, ky vlerësim është

⁵⁶ Shih vendimin nr. 19/2021, pika 96, që i përket subjektit A. Q.; vendimin nr. 9/2020, pikat 17.3 - 17.12, për subjektin A. GJ.

bërë në interpretim të gabuar edhe të nenit 52 të ligjit 84/2016, i cili barrën e provës e përcakton si një të drejtë të subjektit të rivlerësimit dhe jo një detyrim për të.

21.2. Trupi gjykues i Kolegjit, pasi shqyrtoi aktet në fashikull dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit, vlerësoi se qëndrojnë problematikat e konstatuara nga Komisioni. Subjekti ka treguar mangësi në kryerjen e veprimeve hetimore e në arsyetimin e vendimeve, si dhe nuk ka respektuar të drejtat e pjesëmarrësve në proceset penale të verifikuara, kryesisht për shkak të zgjatjes në mënyrë të përsëritur dhe të pajustificuar të afatit të hetimeve. Në këtë konkluzion, trupi gjykues mban në konsideratë mangësitë e konstatuara në të pesta procedimet penale për të cilat Komisioni ka gjetur problematika të indikatorëve të përcaktuar në nenet 75, pika 4 (cenimi i etikës e vlerave profesionale), nenit 73, pika 2 (aspekti i njohurive ligjore nëpërmjet ndërmarrjes së veprimeve për të hetuar e mbledhur prova) dhe 73, pika 3 (arsyetimi dhe cilësia e analizës) të ligjit nr. 96/2016.

21.3. Edhe në vlerësimin e Kolegjit, subjekti nuk arriti të shpjegojë mungesën e veprimeve hetimore në periudha kohore në disa raste disavjeçare. Nga ana tjetër, referimi që bën subjekti në mënyrë të *përsëritur*, në ngjarje të ndodhura në vitin 2020,⁵⁷ për çështje penale të trajtuara përpara këtij momenti në kohë e që nuk mund të ndikoheshin nga sa ndodhi më pas, përveçse nuk justifikojnë në asnjë rast tejzgjatjen e përsëritur të afateve të hetimit, mungesën e arsyetimit të vendimeve për zgjatjen e afatit të hetimit, apo moskryerjen e detyrave të lëna nga gjykata, tregojnë një qasje që karakterizohet nga shkelja e të drejtave procedurale të palëve. Subjekti i rivlerësimit rezulton me një model pune që ka cenuar të drejtat e qytetarëve dhe konsiderohet i papërshtatshëm për të vijuar detyrën, nën dritën e nenit E të Aneksit të Kushtetutës, nenit 44, germa “c”, dhe nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, në vlerësimin e kriterit profesional.

21.4. Së fundmi, në analizë të sa referuar më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vëren se konkluzioni i Komisionit, se sjellja e subjektit të rivlerësimit gjatë procesit, cenon besimin e publikut tek drejtësia, është i bazuar. Subjekti është treguar jo bashkëpunues në procesin e hetimit administrativ, me kontradikta e kundërthënie të përsëritura, sikurse evidentuar tek vlerësimi i kriterit të pasurisë, apo duke mbajtur një linjë përgjigjesh e sjelljesh që duken si përpjekje për të mjegulluar faktet e çuar në lajthim organin administrativ (Komisionin) apo dhënë shpjegime mbi bazën e paaftësisë së përkohshme në punë të vitit 2020, për veprime të cilat i përkasin viteve përpara këtij harku kohor. Parë nën dritën e nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, dhe në vlerësimin tërësor, mënyra sesi subjekti ka zgjedhur të ndërveprojë me Komisionin, cenon besimin e publikut tek ai si funksionar i drejtësisë, për shkak veprimesh e mosveprimesh që pasqyrojnë zgjedhje të tij, të ndërmarra në funksion të mungesës së qartësisë apo manipulimit të rrethanave, para organeve të rivlerësimit. Për rrjedhojë, këto konstatime u bënë pjesë e vlerësimit të kryer nga trupi gjykues i Kolegjit për vlerësimin tërësor të çështjes sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, dhe u gjenden brenda parashikimeve të nenit 61, pika 5 të po këtij ligji. Në vijim, arsyetimi i Kolegjit mbi të cilin u bazua konkluzioni i mësipërm.

⁵⁷ Ngjarjet e referuara në mënyrë të përsëritur janë situata e pandemisë Covid 19 dhe aksidenti rrugor i pësuar prej tij.

21.5. Pretendimi për shtrirjen e hetimit administrativ përtej kufijve të lejuar në ligjin nr. 84/2016, duke marrë në vlerësim çështje penale të hetuara nga subjekti jashtë periudhës së rivlerësimit, është i pabazuar në ligj dhe në akte. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se Komisioni ka shqyrtuar çështjet në përputhje me përcaktimet e pikës 4, të nenit 41, të ligjit nr. 84/2016, i cili lejon shtrirjen e kontrollit të vlerësimit të aftësive profesionale, nga data 01.01.2006 e në vazhdim, sipas informacionit që disponohet.

21.6. Edhe pretendimi se vlerësimi i Komisionit duhet të jetë në linjë me raportin pozitiv të KLP-së, dhe nga analiza e dosjeve penale të përzgjedhura prej tij apo zgjedhura me short, nuk rezultojnë probleme, është i pabazuar qoftë në aspektin ligjor, ashtu edhe me gjendjen faktike që referojnë aktet e administruara. Konkretisht, sikurse arsyetuar edhe në hyrje të këtij arsytimi, nën dritën e dispozitave kushtetuese dhe ligjore dhe jurisprudencës së Kolegjit e GjEDNj-së, nëpërmjet të cilave kanë gjetur ato interpretim, institucionet e rivlerësimit janë autonome në vlerësimin e secilit kriter. Komisioni është brenda tagrave të tij, të arrijë në një konkluzion të ndryshëm nga ai i Këshillit të Lartë të Prokurorisë për vlerësimin e aftësisë profesionale, dhe raporti i tij duhet të jetë jashtë akteve që ka shqyrtuar raporti i institucionit tjetër. Pa përsëritur sa është shtjelluar më sipër në këtë vendim, trupi gjykues i Kolegjit, në këtë pikë, çmon të shtojë edhe që, nëse do të ndiqej logjika e potencuar nga subjekti, organet e rivlerësimit do të kryenin vetëm konfirmimin e raporteve të organeve ndihmëse, pa pasur nevojë të kryenin hetimin e tyre. Qartazi, Kushtetuta dhe ligji nuk parashikojnë këtë rol për organet e rivlerësimit, përkundrazi.

21.7. Nga ana tjetër, dosjet e marra në shqyrtim nga KLP-ja për vlerësimin e subjektit, në raportin e hartuar prej saj, përbëjnë vetëm një pjesë të informacioneve të marra në rrugë ligjore. Komisioni, në ushtrim të tagrave të tij, e ka shtrirë hetimin edhe në disa çështje penale të referuara nga burime të tjera vlerësimi e konkretisht: (i) nga burimet arkivore të Prokurorisë së Përgjithshme, të cilat referuan dy ankesa, njëra prej të cilave⁵⁸ përmendet edhe në raportin e KLP-së, por vetëm si rrethanë, e pa vlerësim, dhe një ankesë tjetër⁵⁹ që nuk gjen referim në atë raport; (ii) në informacionin e marrë nga denoncimet e publikut dhe (iii) në informacionin e marrë nga burimet e hapura (mediat). Për sa më sipër, është e kuptueshme që vlerësimi i Komisionit, edhe për nga ana lëndore, nuk mund të përputhej me raportin e KLP-së.

21.8. Pretendimi i subjektit për shkelje të nenit 6 të KEDNj-së, pasi është shkarkuar për një gjetje apo për një çështje përtej periudhës së rivlerësimit dhe për të cilën Komisioni nuk i ka kaluar barrën e provës, rezulton i pavërtetë. Referuar Rezultateve të Hetimit, Komisioni i ka njoftuar dhe kaluar subjektit barrën e provës për pesë (5) çështje penale -- që i përkasin harkut kohor 2015 – 2019, brenda periudhës së rivlerësimit, në kuptim të pikës 4, të nenit 41, të ligjit nr. 84/2016 -- dhe jo për një (1), sikundër pretendon subjekti në ankim, si më poshtë vijon:

21.8.1. Ndër të dhënat arkivore të Prokurorisë së Përgjithshme, janë veçuar me gjetje: (i) ankesa e T. K. lidhur me kallëzimin penal datë 06.07.2015 dhe (ii) ankesa e S. K. lidhur me kallëzimin penal, datë 21.11.2017, kundër subjektit.

⁵⁸ Ankesa e depozituar nga T. K.

⁵⁹ Ankesa e depozituar nga S. K.

21.8.2. Ndër tetë (8) denoncimet e publikut dhe nga informacioni i marrë nga burimet e hapura (televizioni dhe mediat *online*), janë gjetur me problematika tri (3) raste, e konkretisht: (i) denoncimi i *A. M.*, lidhur me procedimin penal nr. {***}/2018; (ii) denoncimi i *F.* në {***}, për procedimin penal nr. {***}/2017; (iii) denoncimi i *E. SH.* Në {***}, për procedimin penal nr. {***}/2019 ndaj R. F.

21.8.3. Shtrirja e kontrollit për çështjet e mësipërme është bërë e nevojshme për shkak të rrethanave të konstatuara në ankimet/denoncimet/publikimet lidhur me çështjet e hetuara nga subjekti, të cilat paraqisnin rëndësi në drejtim të vlerësimit të kriterit profesional.

21.8.4. Nga analiza tërësore e dokumenteve për pesë dosjet e mësipërme, rezultuan problematika të cilat rezultojnë t'i jenë njoftuar subjektit, duke i kaluar atij barrën e provës për të përmbysur rezultatin e Komisionit. Konkretisht, në faqet 32 dhe 33 të rezultateve të hetimit administrativ, Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës për ankesat nga z. S. K. dhe T. K., nga burimet arkivore të Prokurorisë së Përgjithshme, ndërsa në faqet 34 - 40 të të njëjtit dokument, janë shtjelluar dhe në përfundim kaluar atij barrë prove për të dhëna të cilat Komisioni i ka marrë nga burime të tjera. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se subjekti ka mbajtur një rol pasiv, që konsiston në mosdhënien e shpjegimeve apo dhënien e shpjegimeve tejet të përcipta, mosparaqitjen e dokumenteve shkresore nga dosjet penale të evidentuara, mosprezencën e tij në seancën dëgjimore dhe rolin pasiv të përfaqësueses ligjore sa i takon vlerësimit profesional, me argumentin që ajo do të merrej vetëm me dy kriteret e tjera -- pretendim ky në kundërshtim me tagrat e prokurës së posaçme -- e për pasojë, subjekti nuk ka përmbysur barrën e provës. Të gjitha këto rrethana me të drejtë e kanë çuar Komisionin në një konkluzion të ndryshëm nga ai KLP-së. Trajtimi i detajuar i këtyre rrethanave, arsyetohet në vijim të këtij vendimi të Kolegjit.

21.9. Subjekti pretendon se, edhe sikur të konsideroheshin të mirëqena, gabimet e konstatuara nuk përbëjnë shkelje të rëndë dhe mund t'i ndodhin një magjistrati me nivel mesatar. Në vlerësimin e trupit gjykues të Kolegjit, problematikat e indikatorëve të vlerësimit profesional, të konstatuara nga Komisioni në *të pesta* procedimet penale, e të konfirmuara edhe në Kolegji, paraqiten si një model pune që ka cenuar të drejtat e qytetarëve që u vlerësuan se tregojnë që subjekti është i papërshtatshëm për të vijuar detyrën, nën dritën e nenit E të Aneksit të Kushtetutës, nenit 44, germa "c", dhe nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Ky konkluzion i Kolegjit u bazua në analizën e të pesta çështjeve penale për të cilat i është kaluar subjektit barrë prove, shtjelluar në vijim.

22. *Ankesa e z. T. K.*⁶⁰ -- lidhet me një kallëzim penal të depozituar prej tij më datë 06.07.2015, në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Fier, për veprën penale të falsifikimit të dokumenteve, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal. Hetimet janë ndjekur nga subjekti i rivlerësimit. Pretendimi kryesor i ankuesit është zgjatja e qëllimtë e hetimeve përtej afateve ligjore. Ai, po ashtu, shprehet se nuk ka marrë asnjë informacion mbi hetimet, ndonëse kanë kaluar tri vite prej momentit të regjistrimit të

⁶⁰ Ankuesi *A. K.*, në cilësinë e përfaqësuesit të vëllait të tij, kallëzuesit *T. K.*, i është drejtuar, në datën 22.05.2018, me një ankesë Prokurorisë së Përgjithshme, e cila në vijim ia ka dërguar rastin, për vlerësim dhe zgjidhje ligjore, Prokurorisë së Shkallës së Parë Fier.

kallëzimit. Për shkak të kalimit të çdo afati ligjor, ankuesi ngre dyshime se subjekti i rivlerësimit zvarrit qëllimisht hetimin për të favorizuar të dyshuarit.

22.1. Komisioni i ka njoftuar subjektit pretendimet e ngritura nga ky individ, duke i kërkuar sqarime e dokumente shkresorë për çfarë është vendosur në lidhje me këtë ankesë, si dhe në lidhje me pretendimet e z. K. Në kuadër të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se një ndër oficerët e policisë gjyqësore e ka pritur disa herë ankuesin (kallëzuesin), duke i dhënë informacionin e duhur në lidhje me veprimet hetimore të kryera nga ana e tyre (prokurorit/subjektit dhe OPGj-së). Ai shpjegon se janë kryer një sërë veprimesh hetimore në lidhje me pretendimet e ngritura nga ana e kallëzuesit gjatë intervistimit me OPGj-në. Në ankim, subjekti nuk ka dhënë shpjegime a pretendime konkrete për gjetjet e njoftuara, por potencon vetëm në lidhje me barrën e provës e cila nuk duhet konsideruar si detyrim por si e drejtë për subjektin, dhe se ishte detyrë e Komisionit që të merrte dosjet pranë Prokurorisë Fier. Bashkëlidhur ankimit, subjekti ka depozituar një procesverbal,⁶¹ të mbajtur në datën 12.06.2018, nga OPGj-ja, për pyetjen e përfaqësuesit me prokurë të kallëzuesit, z. A. K., në cilësinë personit që ka dijeni për veprën penale.

22.2. Në analizë të sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit, sikurse edhe Komisioni, konstaton se qëndrojnë problematikat e indikatorëve të vlerësimit profesional sipas ligjit nr. 96/2016, e konkretisht, nenit 73, pika 2 (aspekti i njohurive ligjore nëpërmjet ndërmarrjes së veprimeve për të hetuar e mbledhur prova) dhe nenit 74, pika 4 (aftësia e prokurorit për të kryer në mënyrë të efektshme procedura hetimore). Subjekti i rivlerësimit ka demonstruar mangësi në kryerjen e hetimeve, shfaqur në formën e zvarritjes/tejkalimit të afatit të kryerjes së hetimeve.

22.2.1. *Së pari*, ndërsa në ankim mungojnë tërësisht shpjegimet e subjektit për veprimet hetimore të kësaj çështjeje, në rezultatet e hetimit, ato (shpjegimet) janë dukshëm të përcipta, të përmbledhura vetëm në dy fjali, si referuar më sipër. Këto pretendime nuk janë shoqëruar me akte, ndonëse në bazë të neneve 303 dhe 315 të Kodit të Procedurës Penale, OPGj-ja dhe prokurori kanë detyrimin të mbajnë procesverbal për ankesat e paraqitura me gojë. Subjekti nuk ka depozituar ndonjë procesverbal të mbajtur gjatë intervistimit të ankuesit me OPGj-në. I vetmi dokument i referuar tek prapësimet, është një deklaratë e OPGj-së, të cilin subjekti e relatton si të bashkëlidhur prapësimeve, por që në fakt nuk rezulton të jetë depozituar me to. Edhe duke abstraguuar nga fakti që nuk përmbush kërkesat e provave të reja me ankimin, në kuptim të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, procesverbali bashkëlidhur ankimit,⁶² jo vetëm që nuk hedh dritë mbi veprimet hetimore të pretenduara nga subjekti se janë kryer,⁶³ por mbajtja e këtij procesverbali në datën 12.06.2018, pothuajse 3 vite pas datës 06.07.2015 të depozitimit të kallëzimit penal -- ndërkohë që duhet të ishte ndër veprimet e para hetimore -- duket se përkon me pretendimin e ankuesit T. K., se kjo

⁶¹ Fotokopje e panjësuar me origjinalin.

⁶² Procesverbal, datë 12.06.2018, për marrjen e të dhënave që tregojnë rrethanat e veprës penale nga z. A. K./denoncuesi.

⁶³ Procesverbali bashkëlidhur ankimit, është mbajtur nga OPGj-ja, gjatë pyetjes së përfaqësuesit me prokurë të kallëzuesit, si person që ka dijeni për veprën penale, e për rrjedhojë, nuk paraqet vlerë provuese në drejtim të pretendimit se kallëzuesi është pritur e informuar nga OPGj-ja në lidhje me veprimet hetimore të kryera nga ana e tyre.

dosje është mbajtur pa veprime thuajse për tri vite, e po ashtu përkon edhe me dyshimin e ankuesit për zvarritje të hetimeve.

22.2.2. *Së dyti*, trupi gjykues vëren se subjekti shprehet se janë kryer një sërë veprimesh hetimore, pa u ndalur në shpjegimin konkret të tyre dhe pa depozituar dokumentacion. Nga ana tjetër, subjekti nuk ka dhënë asnjë shpjegim lidhur me afatet e hetimit, nëse janë zgjatur, dhe arsyet e zgjatjes, në mënyrë që t'i jepte mundësi Komisionit (por edhe Kolegjit) të sqaronte situatën lidhur me pretendimet e ankuesit për zgjatje të këtyre afateve, me qëllim parashkrimin e ndjekjes penale për të kallëzuarit.

22.2.3. *Së fundmi*, trupi gjykues i Kolegjit vëren se, në vitin 2015, kur është depozituar kallëzimi penal, dispozita procedurale përcaktonte një afat tremujor për dërgimin e çështjes në gjyq, pushimin ose pezullimin e saj.⁶⁴ Sipas kësaj dispozite (edhe pas ndryshimit në vitin 2017), rezulton se afati 3 mujor i përfundimit të hetimeve, është i lidhur ngushtë me shënimin në regjistrin e njoftimit të veprave penale, të emrit të personit që i atribuohet vepra penale në fjalë. Termi “personi, të cilit i atribuohet vepra penale”, është trajtuar gjerësisht në vendimin e unifikuar nr. 3 datë 27.09.2002, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.⁶⁵ Sipas këtij vendimi, emri i personit të cilit i atribuohet vepra penale shënohet në regjistër vetëm në ato raste kur *kallëzuesi mendon se e di se kush është autori i krimit* (si në rastin konkret, ku denoncuesi/kallëzuesi i ka identifikuar personat e dyshuar sipas tij). Po ashtu, procedura e regjistrimit të emrit të personit që i atribuohet vepra penale, është përcaktuar në Udhëzimin e Prokurorit të Përgjithshëm nr. 241, datë 21.11.2005, “Për regjistrimin e njoftimit të veprës penale dhe të emrit të personit që i atribuohet vepra penale”.⁶⁶ Sipas këtij udhëzimi, në rastin e kallëzimeve, fillimisht regjistrohet njoftimi për veprën penale dhe, pasi administrohen aktet procedurale që i atribuojnë personit kryerjen e veprës

⁶⁴ Neni 323 i Kodit të Procedurës Penale: “1. Brenda tre muajve nga data në të cilën emri i personit që i atribuohet vepra penale është shënuar në regjistrin e njoftimit të veprave penale, prokurori vendos dërgimin e çështjes në gjyq ose pushimin, ose pezullimin e saj. 2. Kur është i nevojshëm autorizimi i procedimit, ecja e afatit pezullohet nga çasti që bëhet kërkesa deri në ditën kur autorizimi i vjen prokurorit”. Kjo dispozitë ka ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.03.2017, si vijon: “1. Brenda përfundimit të afatit ligjor të hetimeve, prokurori vendos sipas paragrafit 6, të nenit 327, të këtij Kodi. 2. Afati i përfundimit të hetimeve është tre muaj nga data në të cilën emri i personit që i atribuohet vepra penale është shënuar në regjistrin e njoftimit të veprave penale, dhe gjashtë muaj për veprat penale të parashikuara nga shkronjat “a” dhe “b”, të nenit 75/a, të këtij Kodi”.

⁶⁵ Kolegjet e Bashkuara, në këtë vendim, ndër të tjera arsyetojnë: “[...] Termin “person të cilit i atribuohet vepra penale” e gjejmë në nenin 287 të K. Pr. Penale, që bën pjesë në kreun e dytë të titullit të gjashtë të kodit, që flet për mënyrën si njoftohet e merr dijëni për veprën penale prokurori dhe policia. Kur njoftuesi mendon se e di se kush është autori i veprës penale, prokurori shënon në regjistrin që mbahet për njoftimin e veprave penale emrin e personit që tregon kallëzuesi, se është ose mund të jetë autor i veprës penale. Nuk ka asnjë dyshim se ky emërtim i përket fazës fillestare të procedimit penal. Termi “person të cilit i atribuohet vepra penale”, i marrë në kontekstin e nenit 287 të K. Pr. Penale, plus momentin procedural në të cilin përdoret, kuptohet se nuk mund të barazohet as me termin “person ndaj të cilit zhvillohen hetime” dhe as me termin “i pandehur”. Emri i personit të cilit i atribuohet vepra penale shënohet në regjistër vetëm në ato raste kur *kallëzuesi mendon se e di se kush është autori i krimit*. Por kjo nuk do të thotë se ai është vërtet autor i veprës penale. Nëse vërtet personi të cilit i atribuohet vepra penale, është apo jo autor i veprës penale, do të dalë nga një hetim i plotë, i gjithanshëm, e në përputhje me ligjin [...]”.

⁶⁶ Udhëzimi nr. 241, datë 21.11.2005, është shtuar/plotësuar/ndryshuar me Udhëzimin nr. 2, datë 27.10.2006 dhe Udhëzimin nr. 3, datë 19.06.2012, “Për një ndryshim dhe një shtesë në Udhëzimin nr. 241, datë 21.11.2005, ‘Për regjistrimin e njoftimit të veprës penale dhe të emrit të personit që i atribuohet vepra penale’ (i ndryshuar)”.

penale, prokurori merr vendim për regjistrimin e emrit. Fakti që ky udhëzim nuk përcakton një afat konkret brenda të cilit duhet të kryhet regjistrimi i emrit të personit që i atribuohet vepra penale, nuk mund të argumentohet në të kundërt se ligjëron çdo afat, dhe as që legjitimon afatin e hetimit, që në këtë rast ka qenë më së paku 3 vjet -- nëse mbajmë në konsideratë faktin që pyetja e kallëzuesit është bërë thujse 3 vite pas datës 06.07.2015 të depozitimit të kallëzimit penal në të cilin, për më tepër, ishin identifikuar edhe dy individët e kallëzuar.

23. *Kallëzimi i z. S. K.* -- Ky person ka depozituar një kallëzim penal në ngarkim të subjektit të rivlerësimit, për *shpërdorim të detyrës dhe fillim të paligjshëm të ndjekjes penale*. Nga aktet bashkëngjitur kallëzimit, rezulton se, pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier, është regjistruar procedimi penal nr. {***}/2015, në ngarkim të kallëzuesit S. K., i dyshuar për veprat penale të *vrasjes me paramendim të kryer në bashkëpunim dhe mbajtjes pa leje të armëve të ftohta*, parashikuar nga nenet 78/25 dhe 279 të Kodit Penal. Ky procedim penal është hetuar nga subjekti i rivlerësimit. Sipas kallëzuesit, subjekti i rivlerësimit ka konsumuar veprat penale të referuara më sipër për shkak se në mungesë të provave, ka nxjerrë një urdhër arresti dhe mbajtur atë padrejtësisht në cilësinë e të pandehurit, ndërkohë që duhet ta pushonte këtë çështje. Gjithashtu, kallëzuesi pretendon se subjekti ka kryer njëkohësisht edhe veprën penale të shpërdorimit të detyrës, për shkak të zgjatjes së afatit të hetimeve, në shkelje të nenit 324 të K. Pr. Penale, zgjatje e cila e ka rënduar së tepërmi pozitën ekonomike të tij, pasi i është privuar e drejta për të lëvizur lirisht dhe për të gjetur një punë në Evropë, për shkak të masës së sigurimit *ndalim për dalje jashtë shtetit*, urdhëruar për të prej datës 31.07.2016.

23.1. Materiali kallëzues ndaj subjektit, i është dërguar për kompetencë Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, dhe është hetuar nga një prokurore e atij institucioni (znj. N. P.), e cila në datën 19.12.2017, ka marrë vendim për mosfillimin e procedimit penal. Ky vendim i është njoftuar kallëzuesit dhe nuk është ankimuar. Vendimi i mosfillimit është marrë bazuar në arsyetimin se: (i) prokurori/subjekti nuk ka konsumuar elementet e veprës penale të “fillimit të paligjshëm të ndjekjes penale”, pasi nga analiza e dokumentacionit të administruar nga dosja penale në ngarkim të z. S. K., ka ekzistuar dyshimi i arsyeshëm bazuar në prova, se ky person ka qenë autor i veprës penale objekt hetimi dhe në bazë të atyre provave, gjykata ka vendosur masën e sigurimit të kërkuar nga prokurori “arrest me burg”, lënë në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit; (ii) prokurorja e çështjes (znj. P.) ka vlerësuar gjithashtu, se subjekti nuk ka konsumuar as elementet e veprës penale të “shpërdorimit të detyrës”, për shkak të mosrespektimit të nenit 324 të Kodit të Procedurës Penale në lidhje me zgjatjen e afateve.

23.2. Në shqyrtim të pretendimeve të ngritura në këtë kallëzim, Komisioni ka konkluduar se pretendimi i kallëzuesit se subjekti ka konsumuar veprën penale “Fillimi i paligjshëm i ndjekjes penale”, lidhet me vlerësimin e provave dhe bie ndesh me detyrimin për të mos zëvendësuar interpretimin ose logjikën e prokurorit. Ndërsa për pretendimin për mosrespektim të afatit të përcaktuar në nenin 324 të Kodit të Procedurës Penale, për zgjatjen e afateve të hetimit, Komisioni i ka kërkuar subjektit të japë sqarime për veprimet e kryera nga ana e tij.

23.3. Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti ka shpjeguar se zgjatja e afatit të hetimeve është kërkuar për shkak se vepra penale ka qenë e rëndë dhe se nga ana e familjarëve të viktimës

janë kërkuar një sërë veprimesh hetimore, pasi kanë pasur dyshime të shumta. Në zgjatjen e afatit të hetimeve kanë ndikuar edhe problemet shëndetësore të vetë subjektit pas aksidentimit të tij, si edhe masat e marra në kuadër të pandemisë *Covid 19*. Subjekti nuk paraqiti asnjë dokument shkresor për të vërtetuar këto pretendime. Edhe për këtë rast, subjekti në ankim nuk potencon shpjegime a pretendime konkrete për gjetjet e njoftuara, por sjell në mënyrë të përsëritur të njëjtat pretendime për barrën e provës, e cila nuk duhet konsideruar si detyrim për të. Bashkëlidhur ankimit, subjekti ka depozituar vendimin e mosfillimit, datë 19.12.2017, të prokurores që ka hetuar kallëzimin penal ndaj subjektit të rivlerësimit.

23.4. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se subjekti i rivlerësimit, edhe në këtë çështje penale, ka demonstruar mangësi në kryerjen e hetimeve, shfaqur në formën e zvarritjes/tejkalimit të afatit të kryerjes së hetimeve, problematikë e cila afekton indikatorët e vlerësimit profesional sipas ligjit nr. 96/2016, e konkretisht, aspektin e njohurive ligjore nëpërmjet ndërmarrjes së veprimeve për të hetuar e mbledhur prova sipas nenit 73, pika 2, apo aftësinë e prokurorit për të kryer në mënyrë të efektshme procedura hetimore në kuptim të nenit 74, pika 4 e të njëjtit ligj. Për mbërritjen në këtë konkluzion, u mbajtën në konsideratë konstatimet e mëposhtme:

23.4.1. Subjekti i rivlerësimit ka parashtruar prapësime të përcipta dhe të mbetura në nivel deklarativ, për shkak se nuk janë mbështetur në akte. Subjekti nuk depozitoi dokumentacion për të provuar pretendimin se familjarët e viktimës kanë kërkuar kryerjen e disa veprimeve hetimore, të cilat pas-sollën nevojën për zgjatjen e afatit të hetimit. Po ashtu, subjekti është mjaftuar vetëm me pretendimin që vepra penale është e rëndë, por nuk ka depozituar asnjë akt që të vërtetojë kompleksitetin e çështjes, apo pamundësinë objektive për t'i përfunduar hetimet brenda afatit, kërkesa këto që burojnë nga neni 324 i Kodit të Procedurës Penale⁶⁷, sipas të cilit, prokurori mund të bëjë zgjatje të mëtejshme, secila për një kohë jo më shumë se tre muaj, *në rastet e hetimeve komplekse ose të pamundësisë objektive për t'i përfunduar ato brenda afatit të zgjatur*. Kjo dispozitë ka parashikuar edhe mundësinë e zgjatjes së afatit të hetimeve tej afatit 2-vjeçar, për veprat penale që gjykohen me trup gjykues,⁶⁸ siç është rasti i vrasjes me paramendim në ngarkim të z. S. K.⁶⁹ Por, në bazë të pikës 2, të nenit 324 të Kodit të Procedurës Penale, ky afat mund të zgjatet vetëm me miratim të Prokurorit të Përgjithshëm.

23.4.2. Në zbatim të këtij detyrimi, subjekti nuk vërtetoi me dokumentacion që zgjatja e afatit të jetë miratuar nga Prokurori i Përgjithshëm në bazë të kërkesës së prokurorit. Edhe shpjegimin e

⁶⁷ Neni 324 parashikon: [...] Prokurori mund ta zgjasë afatin e hetimeve për një kohë deri në tre muaj [...] 2. Zgjatje të mëtejshme, secila për një kohë jo më shumë se tre muaj, mund të bëhen nga prokurori në rastet e hetimeve komplekse ose të pamundësisë objektive për t'i përfunduar ato brenda afatit të zgjatur. Tej afatit 2-vjeçar, për raste të akuzave për krim të organizuar dhe për krime që gjykohen me trup gjykues, afati i hetimit mund të zgjatet vetëm me miratim të Prokurorit të Përgjithshëm ose Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme deri në 1 vit, për çdo zgjatje jo më shumë se tre muaj, pa cenuar afatet e kohëzgjatjes së paraburgimit [...].

⁶⁸ Referuar nenit 13 të K. Pr. Penale, i cili parashikon: [...] Gjykatat e rretheve gjyqësore gjykojnë me një gjyqtar veprat penale, për të cilat parashikohet dënim me gjobë ose me burgim në maksimum jo më shumë se 10 vjet. Veprat e tjera penale gjykohen me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë.

⁶⁹ Neni 78 i K. Penal parashikon: "Vrasja me paramendim dënohet me burgim nga pesëmbëdhjetë gjer në njëzet e pesë vjet. [...]".

subjektit, se në zgjatjen e afatit të hetimeve ka ndikuar gjendja e tij shëndetësore pas aksidentimit dhe pandemia nga Covid 19, trupi gjykues e vlerëson si një përpjekje të subjektit për të krijuar idenë e pamundësisë objektive për të kryer hetime brenda afateve, pasi në fakt asnjëra nga këto situata nuk mund të ketë shërbyer si rrethanë për zgjatjen e afatit të hetimeve. Aksidenti që ka pësuar subjekti dhe pandemia për shkak të Covid 19, janë ngjarje të ndodhura në vitin 2020, ndërkohë që procedimi penal në fjalë, nr. 1688, i përket vitit 2015. Sa më sipër, rezulton se subjekti nuk ka bërë asnjë përpjekje për të provuar me dokumentacion, se ka vepruar në përputhje me shkaqet, afatet dhe procedurat e përcaktuara në nenin 324 të Kodit të Procedurës Penale.

24. *Denoncimi datë 05.06.2019, i depozituar nga z. A. M.* -- Denoncuesi pretendon se subjekti ka ndjekur hetimet lidhur me një kallëzim penal për falsifikim dokumentesh, me kallëzues e të kallëzuar dy individë të tjerë. Sipas denoncuesit, subjekti, pa hetuar në themel mbi dosjen, ka marrë padrejtësisht si të pandehur atë vetë, me detyrë ekspert topograf, duke i njoftuar akuzën për kryerjen e veprës penale “Falsifikimi i dokumenteve” nga personi që ka për detyrë t’i lëshojë ato, e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 186/3 dhe 25 të Kodit Penal.

24.1. Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të dosjes së procedimit penal nr. {***}/2018, Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës në lidhje me konstatimin se, nga ana e subjektit, ka pasur zvarritje të hetimeve, referuar në rend kronologjik si vijon:

24.1.1. Mbi bazën e kallëzimit penal të dy personave [H. e M. TH.], Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier ka regjistruar procedimin penal nr. {***} datë 08.05.2018, ndaj një personi tjetër, z. K. TH., për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal. Sipas kallëzimit, i kallëzuari ka falsifikuar dokumentet duke përfutur një pasuri truall dhe ndërtesë. Më pas, mbi bazën e kallëzimit të të kallëzuarit [z. K. TH.] kundër kallëzueses fillestare [znj. M. TH.], subjekti i rivlerësimit ka regjistruar procedimin penal nr. {***}, datë 26.12.2018, për veprat penale “Falsifikim i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave” dhe “Falsifikimi akteve të gjendjes civile”, parashikuar nga nenet 189 dhe 191 të Kodit Penal. Në datën 28.12.2018, subjekti i rivlerësimit ka bashkuar dy procedimet penale të mësipërme, duke arsyetuar se ato janë regjistruar mbi kallëzimin e dy individëve, në gjini të afërt mes tyre, pretendimet e ngritura janë të njëjta, falsifikim dokumentesh dhe aktet janë në të njëjtën gjendje hetimi nga i njëjti prokuror dhe OPGj.

24.1.2. Nga ana tjetër, e njëjta prokurori, mbi bazën e kallëzimit penal të z. K. TH., ka regjistruar procedimin penal nr. {***}, datë 31.12.2018, për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal. I kallëzuari, H. TH., pretendohet se ka përdorur pranë ALUIZNI-t dokumente të falsifikuara, të përpiluara nga z. A. M./denoncuesi. Ky kallëzim penal është trajtuar fillimisht nga një tjetër prokurore (znj. V. SH.).

24.1.3. Meqenëse procedimet penale të referuara më sipër janë regjistruar mbi kallëzimin e dy individëve, në gjini të afërt mes tyre, dhe pretendimet e ngritura janë të njëjta, falsifikim dokumentesh për të përfutur të njëjtën pasuri, Drejtuesi i Prokurorisë Fier ka vlerësuar se procedimet duhen bashkuar dhe hetimet duhen vazhduar nga prokurori Erind Reovica, i cili ka regjistruar i pari procedimin penal. Me vendimin e datës 31.12.2018, të Drejtuesit të Prokurorisë, është vendosur bashkimi i procedimeve penale dhe zëvendësimi i prokurores V. SH. me prokurorin Erind Reovica, duke u ngarkuar ky i fundit për të vazhduar hetimet.

24.1.4. Pas përfundimit të hetimeve, subjekti i rivlerësimit i është drejtuar në datën 22.05.2019, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, me kërkesë për dërgimin për gjykim të procedimit penal nr. {***}, të vitit 2018, në ngarkim të të pandehurit: (1) A. M., akuzuar për kryerjen e veprës penale “Falsifikimi i dokumenteve” nga personi që ka për detyrë t’i lëshojë ato, e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 186/3 e 25 i Kodit Penal dhe (2) H. TH., akuzuar për kryerjen e veprës penale të “Falsifikimi i dokumenteve” e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 186/2 i Kodit Penal.

24.1.5. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier ka konstatuar se organi i prokurorisë *duhet të kryejë hetime shtesë*, duke thelluar hetimin, për t’i dhënë përgjigje çdo fakti penal që ka dalë gjatë procedimit. Me vendimin⁷⁰ e datës 04.11.2019, gjykata i ka kthyer aktet prokurorisë dhe urdhëruar kryerjen e detyrave të lëna në pjesën arsyetuese të vendimit, si vijon: (i) të hetohet në lidhje me trashëgiminë ligjore; (ii) të bëhet këqyrja pranë arkivit të noteres dhe ZVRPP-së Fier; (iii) të bëhet akt ekspertimi për kontratën e shitjes nr. {***}, datë 19.02.1988 dhe për notë transkriptimi; (iv) të hetohet dhe të kryhen verifikime mbi ndërtesën që kërkohet për t’u legalizuar; (v) të hetohet procedura ligjore e regjistrimit të pronës; (vi) të hetohet për objektin nëse ka kontratë energjie elektrike. Afati i urdhëruar në vendim për kryerjen e këtyre veprimeve hetimore, është 60 ditë, *duke caktuar seancën e ardhshme paraprake, më datë 13.01.2020.*

24.1.6. Më datë 02.02.2020, z. H. TH. i është drejtuar Drejtueses së Prokurorisë Fier me kërkesë për zëvendësimin e prokurorit (subjektit), me argumentin se afati 60-ditor i urdhëruar nga gjykata për përfundimin e hetimeve ka kaluar, dhe nuk po zbatohet nga prokurori për shkaqe shëndetësore. Po kështu, ka kërkuar edhe zëvendësimin e OPGj-së të ngarkuar, për të cilin shprehet se ka humbur besimin për paanësinë e tij. Drejtuesja e prokurorisë, në muajin shkurt 2020⁷¹, ka vendosur zëvendësimin e prokurorit (subjektit) në hetimin e procedimit penal nr. {***}, të vitit 2018, me prokuroren S. B., e cila ka përfaqësuar akuzën në këtë gjykim.

24.1.7. Seanca paraprake e planifikuar për t’u zhvilluar më datë 13.01.2020, pasi është shtyrë disa herë nga gjykata për të realizuar njoftimin e palëve si dhe për të marrë informacion lidhur me plotësimin e detyrave të lëna nga Gjykata, *është riçelur më datë 10.02.2020.* Në përfundim të kësaj seance, gjykata më datë 10.02.2020, ka vendosur *kthimin e akteve të procedimit penal nr. {***}/2018*, Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, me arsyetimin se ky gjykim ishte shtyrë disa herë, dhe se organi i prokurorisë *nuk* ka respektuar detyrat e lëna më herët nga gjykata dhe *as ka arsyetuar pamundësinë objektive të përmbushjes së detyrave brenda afatit të caktuar.*

24.2. Pas kalimit të barrës së provës për sa më sipër referuar, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se ka kryer më pas, të gjitha veprimet hetimore të lëna nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Vonesat kanë ardhur për shkak se kallëzuesi H. TH. nuk ka qenë në Shqipëri, për të bërë të mundur bashkëpunimin për të përcaktuar pretendimet e tij, dhe se nuk është realizuar në kohë akt ekspertimi teknik nga ana e ekspertës, e cila ka qenë me Covid 19. Sipas shpjegimeve të subjektit,

⁷⁰ Vendimi nr. Akti {***}, datë regjistrimi 01.07.2019, datë vendimi 04.11.2019.

⁷¹ Me vendimin “Për zëvendësimin e prokurorit”, datë ____ .02.2020 (mungon data).

vonesat janë shkaktuar edhe si rezultat i aksidentimit të tij, më datë 16.01.2020, duke u bërë i paaftë për punë për një periudhë dymujore dhe më pas, pamundësia ka vijuar për shkak të karantinës së vendosur në kuadrin e masave *anticovid*. Subjekti nuk ka paraqitur dokumente shkresore për të vërtetuar pretendimet e tij

24.3. Edhe duke abstraguuar nga fakti që në ankim subjekti nuk potencon mbi rastin konkret, por ngre në mënyrë të përgjithshme të njëjtat pretendime mbi barrën e provës, trupi gjykues i Kolegjit i vlerësoi të pabazuara në akte, pretendimet e ngritura në Komision në kuadër të barrës së provës. Duke mbajtur në konsideratë faktin se, që prej muajit shkurt 2020, hetimet e çështjes kanë vijuar nga një tjetër prokurore⁷², trupi gjykues vëren se referimi që bën subjekti në ngjarje të ndodhura në vitin 2020⁷³, për hetime penale të kryera përpara këtij momenti, në kohë që nuk mund të ndikoheshin nga sa ndodhi më pas, përveçse nuk justifikojnë në asnjë rast tejzgjatjen e përsëritur të afateve të hetimit, mungesën e arsytimit të vendimeve për zgjatjen e afatit të hetimit, apo moskryerjen e detyrave të lëna nga gjykata, tregojnë një qasje që karakterizohet nga shkelja e të drejtave procedurale të palëve. Konkretisht,⁷⁴ paaftësia për punë e subjektit ka filluar në datën 16.01.2020, ndërkohë që afati i urdhëruar nga gjykata për kryerjen e detyrave të caktuara prej saj (60 ditë nga data 04.11.2019 i këtij vendimi), *përfundonte në datën 04.01.2020, e gjithsesi, jo më larg se data për 13.01.2020*, e planifikuar për zhvillimin e seancës gjyqësore. Po kështu, pandemia *Covid 19* nuk mund të ketë shërbyer si faktor vonese apo pamundësie objektive, pasi masat e veçanta në fushën e veprimtarisë gjyqësore janë marrë pas muajit shkurt 2020 të zëvendësimit të subjektit me prokuroren që vijoi hetimet pas kësaj date. Së fundmi, trupi gjykues i Kolegjit nënvizon faktin se mosveprimi *pa shkak* i subjektit të rivlerësimit, është konstatuar edhe nga gjykata e rrethit gjyqësor Fier, e cila me vendimin⁷⁵ e datës 10.02.2020, ka vendosur kthimin e akteve prokurorisë duke argumentuar se: *[...] në rastin konkret, organi i prokurorisë kishte detyrimin të përmbushte detyrat e lëna nga gjykata brenda afatit të caktuar, si dhe nëse kërkonte afat shtesë, duhet ta justifikonte ligjërisht atë edhe me prova të besueshme se veprimet hetimore ishin ndërmarë, dhe procedimi nuk po përfundonte për shkaqe të pavarura nga organi i akuzës. Në rastin konkret, organi i prokurorisë nuk i ka përmbushur këto detyra, duke mos dhënë asnjë shpjegim bindës për gjykatën [...].*

24.4. Në konkluzion të sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se subjekti ka dështuar të provojë me dokumentacion, moskryerjen prej tij të veprimeve hetimore të urdhëruara nga gjykata.

25. *Denoncimi i z. S. F., në {***}* -- Denoncuesi pretendon se është aksidentuar në nëntor të vitit 2017, dhe pas një viti prokuroria ka pushuar procedimin penal me argumentin se drejtuesi i mjetit *nuk*

⁷² Referuar dokumentacionit që administrohet në përmbajtje të fashikullit hetimor të procedimit penal, është evidente se detyrat e lëna nga gjykata për t'u kryer brenda datës 13.01.2020, nuk janë kryer nga subjekti, por nga Oficeri i Policisë Gjyqësore, tashmë nën drejtimin e prokurores S. B., që ka zëvendësuar subjektin, pas kthimit të akteve Prokurorisë, me vendimin e gjykatës nr. {***}, datë 10.02.2020.

⁷³ Ngjarjet e referuara në mënyrë të përsëritur janë situata e pandemisë *Covid 19* dhe aksidenti rrugor i pësuar prej tij.

⁷⁴ Paaftësia për punë ka zgjatur në periudhën 16.01.2020 – 18.03.2020, referuar raporteve mjekësore të depozituara në Komision, nga bashkëshortja e subjektit.

⁷⁵ Nr. vendimi {***}, datë 10.02.2020.

ka shkelur rregullat e qarkullimit. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier ka urdhëruar prokurorinë të rihetonte ngjarjen dhe brenda 30 ditësh ta dërgonte dosjen për hetim. Denoncuesi pretendon se çështja është ndjekur nga subjekti i rivlerësimit, i cili, megjithëse kanë kaluar më shumë se 2 vjet nga ngjarja, nuk ka bërë asnjë veprim hetimor “duke e lënë në sirtar”.

25.1. Me rezultatet e hetimit, subjektit i është kaluar barra e provës lidhur me konstatimet e Komisionit se: (i) ka zvarritje të hetimeve nga subjekti i rivlerësimit, pasi konstatohen 13 vendime për shtyrje të afatit të hetimeve, me përmbajtje të njëjtë, përveç datave, dhe të paarsyetuara për sa i përket shkaqeve të shtyrjes së afatit dhe pamundësisë për t’i përfunduar hetimet brenda afatit të caktuar, sipas kritereve të pikës 2, të nenit 324 të Kodit të Procedurës Penale; (ii) nuk ka urdhër të prokurorit për rifillimin e hetimeve, pas vendimit datë 03.10.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, e cila ka vendosur rrëzimin e kërkesës dhe kthimin e akteve prokurorit, për vazhdimin e hetimeve sipas drejtimeve të lëna nga gjykata brenda një afati prej 30 ditësh; (iii) veprimet hetimore të lëna si detyrë, janë bërë jashtë çdo afati pasi janë kryer pas një periudhe prej gati 2 vitesh nga vendimi i gjykatës [veprimi i parë hetimor ka qenë kryerja e riekspertimit teknik, që është kryer në datën 20.02.2021, kurse veprimi tjetër hetimor, pyetja e të dëmtuarit, është kryer në datën 27.04.2021]; (iv) nga prokurori i çështjes nuk janë kryer veprime hetimore për një periudhë gati 2-vjeçare; (v) subjektit i është kërkuar të japë shpjegime edhe në lidhje me vijimësinë e procedimit penal të kallëzimit penal depozituar ndaj tij pranë Prokurorisë së Posaçme, e cila ia ka përcjellë për ndjekje Prokurorisë Lushnjë.

25.2. Subjekti ka prapësuar përciptazi konstatimet e mësipërme të Komisionit, duke pretenduar se afati është tejkaluar për shkak të paaftësisë së përkohshme në punë pas aksidentit të pësuar prej tij dhe për shkak të pandemisë *Covid 19*, kohë gjatë të cilës aktiviteti i prokurorisë është pezulluar.

25.3. Njëjtë si në rastet e mësipërme, edhe për këtë çështje, nuk rezultojnë pretendime konkrete, përveç atyre të përgjithshme që lidhen me barrën e provës. Për trajtim shterues të çdo pretendimi, trupi gjykues i Kolegjit verifikoi pretendimet e ngritura me parashtrimet në Komision, duke prezumuar se subjekti u qëndron edhe në ankim. Në funksion të verifikimit të sa më sipër pretenduar, trupi gjykues i Kolegjit mori në shqyrtim dokumentacionin e dosjes së procedimit penal nr. {***}, datë 20.11.2017, nga i cili në mënyrë të përmbledhur dhe në rend kronologjik, konstatoi rrethanat e çështjes si më poshtë vijon:

25.3.1. Subjekti ka urdhëruar më datë 20.11.2017, regjistrimin e procedimit penal në ngarkim të individit të akuzuar për kryerjen e veprës penale “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290/2 i Kodit Penal. Pas regjistrimit të procedimit penal, subjekti, më datë 24.11.2017, ka deleguar OPGj-në për kryerjen e veprimeve hetimore brenda datës 15.12.2017.

25.3.2. Në datën 09.02.2018, prokurori/subjekti ka njoftuar të dyshuarin/akuzuarin dhe trashëgimtarët e viktimës, mbi përfundimin e hetimeve, duke arsyetuar se janë siguruar të dhëna të mjaftueshme se i dyshuari nuk ka konsumuar elementet e veprës penale të hetuar. Sipas njoftimit, hetimet kanë përfunduar dhe nuk është e nevojshme kryerja e veprimeve procedurale. Marrja dijani e kësaj shkrese është konfirmuar nga i dyshuari, si edhe nga trashëgimtari i viktimës, i cili përbri nënshkrimit ka vënë shënimin se kërkon të pajiset me kopje të akteve.

25.3.3. Pas një muaji, me shkresën datë 23.03.2018, subjekti i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, me kërkesë për pushimin e çështjes penale, për shkak të arsytimit të sipërcituar. Subjekti, me vendimet e datave 20.02.2018, 20.05.2018 dhe 20.08.2018, ka vendosur *tri (3) herë* zgjatje të afatit të hetimeve, me një periudhë 3 muaj për secilin vendim. Në këto vendime, konstatohet se janë përshkruar të njëjtat veprime hetimore të kryera deri në atë moment, dhe pa argumentuar mbi shkaqet përse nevojitet kjo shtyrje. Nga ana tjetër, përveç mosargumentimit të shkaqeve që diktonin nevojën për zgjatjen e afatit të hetimeve, mbetet e paqartë nga pikëpamja kohore, nevoja e marrjes së këtyre vendimeve pas datës 09.02.2018 të njoftimit të përfundimit të hetimeve, dhe pas datës 23.03.2018, në të cilën çështja ishte dërguar në gjykatë me kërkesë për pushim të procedimit penal.

25.3.4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, më datë 03.10.2018, ka vendosur⁷⁶ rrëzimin e kërkesës për pushimin e çështjes penale dhe *kthimin e akteve prokurorit* për vazhdimin e hetimeve sipas drejtimeve të lëna nga gjykata, e konkretisht: (i) pyetja e të dëmtuarit; (ii) administrimi i kartelës shëndetësore të viktimës ditën e ngjarjes pranë spitalit të Fierit; (iii) kryerja e një akti të ri ekspertimi autoteknik nga një grup ekspertësh. Afati i urdhëruar në vendim për kryerjen e këtyre veprimeve hetimore, është *30 ditë*. Sipas nenit 329, pika 6, të Kodit të Procedurës Penale, ky vendim i gjyqtarit të seancës paraprake, mund të ankimohej *vetëm* nga prokurori/subjekti, por nga aktet që administrohen në fashikullin e procedimit penal në fjalë, nuk rezulton që ky vendim të jetë ankimuar.

25.3.5. Trupi gjykues konstaton se afati 30-ditor i caktuar nga gjykata në vendimin nr. {***}, datë 03.10.2018, *përfundonte në datën 17.11.2018*, referuar faktit që vendimi i gjykatës është administruar në prokurori dhe sigluar subjektit për veprim, në datën 17.10.2018. Rezulton se veprimet hetimore të urdhëruara nga gjykata janë kryer nga ana e subjektit përtej afatit 30-ditor. Konkretisht, në datën 20.02.2019, subjekti ka vendosur kryerjen e riekspertimit autoteknik, lënë si detyrë nga gjykata, ndërsa akti i riekspertimit është kryer pas dy vitesh, në datën 06.03.2021. Në datën 19.04.2021, është urdhëruar paraqitja në prokurori e të dëmtuarit, i cili në datën 27.04.2021, është pyetur në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale. Pas datës 17.11.2018, të përfundimit të afatit 30-ditor, të caktuar nga Gjykata Fier për kryerjen e veprimeve hetimore, subjekti ka vendosur *dy (2) herë* të tjera zgjatjen e afatit të hetimeve, me vendimet e datës 20.11.2018 dhe 20.02.2019, duke përshkruar të njëjtat veprime hetimore si në tri vendimet e mëparshme, pa argumente mbi shkaqet përse nevojitet kjo shtyrje.

25.3.6. Më datë 24.04.2019, i dëmtuari/denoncuesi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier me kërkesën për zëvendësimin e prokurorit/subjektit në hetimin e procedimit, për shkak të moskryerjes së hetimeve, tejkalimit të afateve dhe mospërbushjes së detyrave të lëna nga gjykata. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. {***}, datë 26.04.2019, ka shpallur mungesën e juridiksionit në lidhje me shqyrtimin e kësaj çështjeje dhe dërgimin e akteve në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Fier, për marrjen në shqyrtim të kësaj kërkesë.

⁷⁶ Me vendimin nr. {***}, datë 03.10.2018.

25.3.7. Edhe pas këtij momenti, subjekti ka vijuar sërish me zgjatjen e afatit të hetimeve, me *tetë* (8) vendime të tjera, të marra përkatësisht në datat 20.05.2019, 20.08.2019, 20.11.2019, 20.02.2020, 20.05.2020, 20.08.2020, 20.11.2020 dhe 20.02.2021, me të njëjtin përshkrim veprimesh hetimore si në vendimet e mëparshme, pa argumente mbi shkaqet përse nevojitet kjo shtyrje.

25.3.8. Me shkresën e datës 07.05.2021, subjekti ka përcjellë në gjykatë, kërkesën për pushimin e procedimit penal nr. {***}, të vitit 2017, për veprën penale “Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”. Në këtë kërkesë evidentohet kryerja e aktit të riekspertimit autoteknik, të datës 28.02.2021.

25.4. Bazuar në sa më sipër konstatuar, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson, njëjtë si Komisioni, se në hetimin e kësaj çështje penale ka pasur *zvarritje* të hetimeve nga ana e subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të çështjes, e po ashtu, *mungesë arsyetimi* në aktet e përpiluara prej tij. Këto rrethana afektojnë indikatorët e vlerësimit profesional të përcaktuar në ligjin nr. 96/2016, e konkretisht në nenin 73, pika 2 (aspekti i njohurive ligjore nëpërmjet ndërmarrjes së veprimeve për të hetuar e mbledhur prova), nenin 73, pika 3 (arsyetimi dhe cilësia e analizës) dhe nenin 74, pikat 2 e 4 (respektimi i afateve ligjore dhe aftësia për të kryer në mënyrë të efektshme procedura hetimore). Subjekti ka dështuar të provojë me dokumentacion arsyet që diktuan moskryerjen e veprimeve hetimore brenda afateve të urdhëruara nga gjykata. Ky vlerësim u bazua në rrethanat e referuara më sipër dhe konkluzionet lidhur me to, arsyetuar në vijim:

25.4.1. *Së pari*, afati 30-ditor i caktuar nga gjykata me vendimin datë 03.10.2018, për kryerjen e detyrave të arsyetuar në vendim, nuk është respektuar nga ana e subjektit të rivlerësimit. Detyrat e ngarkuara, jo vetëm nuk janë kryer brenda 30 ditëve, por datojnë shumë më vonë, në vitin 2021.

25.4.2. *Së dyti*, si paaftësia shëndetësore për punë e subjektit, ashtu edhe gjendja e karantinës, janë ngjarje të ndodhura pas datës 17.11.2018, në të cilin përfundonte afati 30-ditor i caktuar nga gjykata si afati maksimal për përfundimin e hetimeve, dhe si të tilla, nuk mund të kenë shërbyer si faktorë që kanë penguar subjektin e rivlerësimit në kryerjen e detyrave të lëna, brenda afatit të përcaktuar. Konkretisht, ngjarja aksidentale dhe paaftësimi për punë i vetë subjektit, ka ndodhur në periudhën 16.01.2020 - 18.03.2020, ndërsa masat e veçanta në fushën e veprimtarisë gjyqësore të marra gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së pandemisë, kanë zgjatur nga data 25.03.2020 deri më datë 27.04.2020, sikurse arsyetuar më sipër për denoncimin e A. M. Për më tepër, referuar Udhëzimit nr. 04/2020, të Prokurorit të Përgjithshëm, masat e marra nënkuptonin kufizimin e kryerjes së veprimeve hetimore, *përveç rasteve kur nga vonesat mund të dëmtoheshin hetimet, apo kryerja e tyre nuk mund të shtyhej për shkak të afateve procedurale* (siç është rasti në fjalë ku gjykata kishte caktuar afat).

25.4.3. *Së treti*, në të trembëdhjetë (13) vendimet për zgjatje afati të marra nga subjekti, konstatohet mungesë argumentimi mbi shkaqet që kanë diktuar nevojën për zgjatjen e afatit të hetimit. Në kuptim të nenit 324/2 të Kodit të Procedurës Penale, dhe referuar Udhëzimit të Prokurorit të Përgjithshëm nr. 3, datë 08. 03. 2007, “Për përmirësimin e punës dhe kontrollit të prokurorit në ndjekjen penale”, arsye të tilla mund të jenë: kompleksiteti i çështjes, vështirësitë që kanë rezultuar gjatë hetimeve, apo rrethana të tjera që kanë pamundësuar kryerjen e të gjitha

veprimeve hetimore të nevojshme për sqarimin e plotë së të gjitha rrethanave të çështjes penale. Në një vështrim të këtyre vendimeve, konstatohet se të gjitha vendimet janë identike sa i përket përmbajtjes, dhe i vetmi element që i bën të ndryshëm nga njëri-tjetri, është elementi i datës së vendimit. Në asnjë prej këtyre vendimeve nuk përmendet si shkak për zgjatjen e hetimit, paaftësia shëndetësore për punë e subjektit, gjendja e karantinës të vendosur për shkak të pandemisë, apo ndonjë rrethanë tjetër. Këto vendime konstatohet se janë marrë në shkelje të nenit 324, pika 2, të Kodit të Procedurës Penale, pasi subjekti i rivlerësimit ka zgjatur hetimin e regjistruar më datë 20.11.2017, tej afatit 2-vjeçar, pa marrë miratimin e Prokurorit të Përgjithshëm.

25.4.4. *Së katërti*, ndër 13 vendime për zgjatjen e afatit të hetimeve, dhjetë (10) prej tyre⁷⁷ të marra pas datës 17.11.2018, që shënonte përfundimin e afatit 30-ditor të caktuar nga gjykata, rezultojnë me problematika edhe nga pikëpamja procedurale. Ato janë marrë në tejkalim të kompetencës së prokurorit, pasi ky i fundit, në zbatim të nenit 332/ç të Kodit të Procedurës Penale, duhej t'i drejtohej gjykatës me kërkesë për zgjatjen e afatit të caktuar prej saj. Prokurori, mund të vendosë zgjatjen e afatit të hetimeve, kryesisht me iniciativë të tij dhe pa investuar gjykatën vetëm gjatë fazës së hetimeve paraprake, në bazë të neneve 323, 324 të Kodit të Procedurës Penale. Në rastin konkret, faza e hetimeve paraprake ka përfunduar që më datë 23.03.2018, kur subjekti ka njoftuar përfundimin e hetimeve dhe i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, me kërkesë për pushimin e procedimit penal nr. {***}, të vitit 2017.

25.4.5. Vendimet për zgjatje afati, të marra pas afatit 30-ditor të caktuar nga gjykata, vijnë në kundërshtim me nenet 329, pika 3, germa b⁷⁸, dhe 329/b, pikat 3 dhe 4⁷⁹ të Kodit të Procedurës Penale, në bazë të të cilave, gjykata ka caktuar një afat për kryerjen e hetimeve, e si e tillë është po ajo, që pasi shqyrton kërkesën e prokurorit për zgjatje afati, vendos nëse afati i caktuar prej saj për kryerjen e hetimeve, duhet shtyrë ose jo. Në kuptim të kësaj dispozite, subjekti nuk duhej të vendoste me iniciativën e tij zgjatjen e afatit, por duhej t'i drejtohej me kërkesë gjykatës për zgjatjen e afatit të hetimeve të caktuar prej saj në vendimin nr. {***}, datë 03.10.2018, ku të parashtronte në mënyrë të argumentuar arsyet objektive që kishin pamundësuar respektimin e afatit të caktuar prej saj, duke diktuar nevojën për zgjatjen e këtij afati. Kjo rrethanë, e cila nuk rezulton të jetë konstatuar nga Komisioni, por rezulton nga analiza e kryer nga Kolegji, nuk u bë pjesë e vlerësimit, nën dritën e garancive procedurale që gëzon subjekti me ankimin.

25.4.6. *Së fundmi*, trupi gjykues mori në analizë edhe vendimin e datës 14.04.2021, bashkëlidhur ankimit, me anë të të cilit, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lushnjë ka vendosur mosfillimin e

⁷⁷ Të marra në datat 20.11.2018, 20.02.2019, 20.05.2019, 20.08.2019, 20.11.2019, 20.02.2020, 20.05.2020, 20.08.2020, 20.11.2020 dhe 20.02.2021.

⁷⁸ Neni 329, pika 3, germa b e K. Pr. Penale parashikon: [...] Gjykata vendos sipas rastit [...] b) kthimin e akteve prokurorit dhe vazhdimin e hetimeve, kur çmon se ato janë të paplota, duke përcaktuar drejtëtimet e thellimit të tyre dhe, kur është rasti, edhe veprimet që duhet të kryhen, si dhe cakton afatin brenda të cilit hetimet duhet të përfundojnë [...].

⁷⁹ Neni 329/b, pikat 3 dhe 4, të K. Pr. Penale parashikon: [...] 3. Kur janë kushtet e parashikuara nga paragrafi 1, i nenit 328, gjykata vendos pushimin e akuzës ose çështjes. Në rast të kundërt, gjykata vendos sipas parashikimeve të shkronjës "b" ose "c", të paragrafit 3, të nenit 329, të këtij Kodi [...] 4. Kur gjykata vendos sipas shkronjës "b", të paragrafit 3, të nenit 329, të këtij Kodi, i cakton prokurorit një afat për kryerjen e hetimeve [...].

procedimit penal për materialin kallëzues⁸⁰ ndaj subjektit për veprën penale të shpërdorimit të detyrës, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Edhe duke abstraguar nga fakti që nuk përmbush kërkesat e provave të reja me ankimin, në kuptim të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, trupi gjykues i Kolegjit vëren se, teksa janë evidentuar vetëm disa veprime të subjektit, sikurse ai për kryerjen e riekspertimit teknik, administrimi i aktit të ekspertimit dhe marrja e vendimeve për zgjatjen e afateve të hetimit, në këtë vendim mungon tërësisht analiza e gjykatës mbi rregullsinë e veprimeve hetimore në raport me afatet ligjore. Në këtë vendim mosfillimi, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë ka arsyetuar se pretendimet për shkelje të dispozitave procedurale, edhe nëse konsiderohen të bazuara, nuk përbëjnë vepër penale. Ato mund të ankimohen në gjykatë apo institucionet eprore, për vlerësim nga ana e tyre.

26. *Denoncimi në emisionin “{***}”, në {***}*⁸¹ -- Denoncuesi E. SH. (në cilësinë e djalit të viktimës), pretendon se aksidentuesi i babait të tij/i dyshuari R. F., ka dhënë mitë në polici, në prokurori dhe ekspertëve, kundrejt lirit nga burgu. Sipas denoncuesit, (i) Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier vendosi masën e sigurisë “arrest me burg” për të dyshuarin R. F., dhe në vijim Gjykata e Apelit Vlorë e zëvendësoi me masën “arrest shtëpie”, por me vlerësimin që nëse do të ketë raporte të tjera, prokuroria mund të kërkojë ndryshimin e masës së sigurisë. Në vijim të hetimeve, ekspertët rrugorë dolën në konkluzionin se fajtor ishte i dyshuari e megjithatë, subjekti nuk kërkoi në gjykatë ndryshimin e masës së sigurisë, duke vijuar ta hetojë atë me masën e sigurimit “arrest në shtëpi”. (ii) I arrestuari R. F. ka thyer masën e sigurimit të arrestit në shtëpi, duke qarkulluar dhe punuar i lirë në qytetin e Fierit.

26.1. Komisioni i ka kërkuar subjektit të shpjegojë e provojë mbi rrethanën e thyerjes së masës së sigurimit “arrest shtëpie” nga i arrestuari R. F. Në parashtrimet e dërguara në Komision, subjekti ka shpjeguar, me një fjali, vetëm që nga ana e tij nuk është ndryshuar masa e sigurimit, ndërsa ka heshtur në lidhje me të vetmen rrethanë për të cilën iu kalua barra e provës, konkretisht për kontrollin e respektimit të urdhrave të dhëna ndaj të pandehurit.

26.2. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson të abstragojë nga pretendimi i parë i denoncuesit, se subjekti nuk kërkoi në gjykatë ndryshimin e masës së sigurisë, i cili lidhet me vlerësimin e provave nga prokurori e për pasojë, është jashtë tagrave të organeve të rivlerësimit nën dritën e nenit 73 të ligjit nr. 96/2016. Ndërsa për pretendimin për thyerjen e masës së sigurimit të arrestit në shtëpi, trupi gjykues vlerëson se në bazë të nenit 8 të ligjit nr. 79/2020, “Për ekzekutimin e vendimeve penale”,⁸² por edhe nenit 9 të ligjit të mëparshëm nr. 8331, datë 21.04.1998, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të çështjes, ka pasur përgjegjësinë të kontrollojë rregullsinë e ekzekutimit të vendimit penal, në përputhje me urdhërimet e gjykatës. Duke mos dhënë asnjë shpjegim dhe

⁸⁰ Depozituar nga denoncuesi në Prokurorinë e Posaçme dhe përcjellë për kompetencë Prokurorisë Lushnjë.

⁸¹ <https://top-channel.tv/2020/09/24/skandali-ne-fiks-fare-aksidenti-me-6-viktima-20-mije-euro-per-lirim-n-ga-burgu/> dhe <https://top-channel.tv/video/fiks-fare-skandali-ne-fiks-fare-aksidenti-me-6-viktima-20-mije-euro-per-lirim-n-ga-burgu/>

⁸² Neni 8 i ligjit nr. 79/2020, “Përgjegjësitë e prokurorit”, parashikon: “Prokurori është i detyruar të marrë të gjitha masat për ekzekutimin e vendimit penal në përputhje me urdhërimet e gjykatës dhe kërkesat e këtij ligji, si dhe të kontrollojë rregullsinë e ekzekutimit. Në rast të konstatimit të parregullsive, prokurori ka të drejtë t’i kërkojë organit përgjegjës ose gjykatës rivendosjen e të drejtës së shkelur, si dhe marrjen e masave ndaj personave përgjegjës”.

mos sjellë asnjë dokumentacion për këtë aspekt, subjekti ka dështuar të provojë të kundërtën e barrës së provës së ngarkuar për këtë çështje.

27. Subjekti i rivlerësimit pretendon se gjetjet e Komisionit nuk duhen vlerësuar si shkelje të rënda, por si gabime sporadike që mund t'i ndodhin çdo magjistrati me nivel mesatar. Trupi gjykues i Kolegjit e gjen të pabazuar këtë pretendim. Nga të gjitha rastet e analizuara më sipër, të shqyrtuara në Komision, edhe në Kolegj rezultuan mangësi profesionale dhe organizative që në mënyrë të përmbledhur konsistojnë në: (i) zvarritje të procesit të hetimit; (ii) zgjatje të afateve të hetimit në mënyrë të paargumentuar dhe në kundërshtim me kushtet, afatet dhe procedurat e përcaktuara në nenet 323 e 324 të Kodit të Procedurës Penale. Përveçse në kundërshtim me dispozitat procedurale të detyrueshme për zbatim, këto veprime e kjo mënyrë sjelljeje është e përsëritur e si rrjedhojë, nuk mund të argumentohet si gabim sporadik. Ato në thelb tregojnë qasje të vazhdueshme e të përsëritura të subjektit të rivlerësimit kundrejt hetimit dhe kohëzgjatjes së tij, por edhe përkundrejt të drejtave të palëve për afate të arsyeshme. Si të tilla, këto konstatime nuk mund të mbeten në nivelin e gabimeve të lehta, apo që mund t'i ndodhin çdo magjistrati me nivel mesatar, sikundër i pretendon subjekti i rivlerësimit. Në vlerësimin e trupit gjykues, këto elemente përbëjnë tregues përcaktues për vlerësimin e aftësive profesionale dhe organizative të magjistratit, në kuptim të neneve 73, 74 dhe 75 të ligjit nr. 96/2016. Sa më sipër, trupi gjykues e gjen të drejtë vlerësimin e Komisionit, se subjekti i rivlerësimit, për asnjë prej rasteve të referuara në rezultatet e hetimit, nuk vërtetoi që ka treguar aftësi të mira profesionale, organizative dhe etike, sipas parashikimit të këtyre dispozitave ligjore.

28. Subjekti pretendon se Komisioni ka keqinterpretuar nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, duke e konsideruar barrën e provës si një detyrim dhe jo si një të drejtë të subjektit të rivlerësimit, e po kështu, në mënyrë të padrejtë ka aplikuar edhe pikën 5, të nenit E të Aneksit të Kushtetutës, duke konsideruar mosdhënien e shpjegimeve prej tij, si pengim apo vështirësim të vlerësimit, ndërkohë që në këndvështrimin e subjektit, pengim apo vështirësim i procesit, konsiderohen veprimet konkrete të kryera prej subjektit për të penguar vlerësimin, dhe jo mosdhënia e shpjegimeve prej tij. Lidhur me këtë pretendim, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson si më poshtë:

28.1. Neni Ç, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, parashikon se barra e provës i kalon subjektit të rivlerësimit vetëm për këtë proces, duke përfshirë çdo proces tjetër, në veçanti procesin penal. Po kështu, neni 52 i ligjit nr. 84/2016, parashikon se nëse Komisioni ose Kolegji i Apelit arrin në përfundimin se provat kanë nivelin e provueshmërisë, sipas nenit 45 të këtij ligji, subjekti i rivlerësimit ka barrën e provës për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën. Ndërsa neni 48 i të njëjtit ligj, parashikon se subjekti i rivlerësimit bashkëpunon me Komisionin dhe Kolegjin e Apelit, të cilët, në marrjen e vendimit, mbajnë parasysh gatishmërinë dhe sjelljen e subjektit të rivlerësimit gjatë procesit.

28.2. Parë në kontekstin e qëllimit të procesit të rivlerësimit, për rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e drejtësisë, barra e provës përbën një obligim të subjektit, sikurse nënkupton edhe vetë fjala në kuptim gramatikor, ndonëse mbetet diskrecion i subjektit të zgjedhë mënyrën se si do të mbrohet -- nëse do të investohet maksimalisht për të vërtetuar të kundërtën e asaj që pretendohet, apo të refuzojë të përgjigjet ose neglizhojë përgjigjen, në rastin më të mirë. Por, nëse

ngrihen gjetje të cilat më pas në varësi të përgjigjeve të subjektit, mund të rishikohen ose mund të shkojnë deri në nivelin e konkluzionit, është në interes të subjektit të shfrytëzojë barrën e provës, si të vetmin mjet ligjor për të vërtetuar të kundërtën.

28.3. Pavarësisht nga mënyra sesi perceptohet barra e provës, ajo përbën një mjet ligjor në interes të subjektit. Nëse subjekti zgjedh ta anashkalojë këtë mundësi, me vetëdije (apo neglizhencë në rastin më të mirë), kundërshtimi i vlerësimit të Komisionit për çështje për të cilat i është ofruar mundësia të mbrohej, bëhet i pakuptimtë. Sa i përket rëndësisë që do të paraqiste sjellja dhe bashkëpunimi i tij me Komisionin dhe peshën që do të mbante ky ndërveprim në kuptim të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, subjekti është informuar jo vetëm në nisje të procesit administrativ, përmes *email*-it të dërgimit të pyetësorit standard, por edhe në komunikimet elektronike të zhvilluara përgjatë procesit administrativ në kërkimet për shtyrje të afateve të hetimit.

28.4. Sa i përket aplikimit të pikës 5, të nenit E të Aneksit të Kushtetutës, trupi gjykues vlerëson se kjo dispozitë parashikon pasojën ligjore, si në rastin kur subjekti kryen veprime për të penguar ose vështirësuar vlerësimin e tij, ashtu edhe kur rezulton se ka njohuri, aftësi, gjykim, qëndrime, ose një model pune aq të dobët sa rrezikon ose cenon të drejtat e qytetarëve. Në vijim të arsyetimit në paragrafët e mësipërm, subjekti gjendet në të dyja rrethanat e kësaj dispozite ligjore. Kështu, në pikën nr. 123 të vendimit objekt ankimi, ndër konkluzionet përmbyllëse të vlerësimit të kriterit profesional, është evidentuar edhe vështirësimi i procesit të rivlerësimit kalimtar nëpërmjet rolit jobashkëpunues të subjektit gjatë hetimeve për kriterin profesional. Referuar pikave 124 dhe 125 të të njëjtit vendim, rezulton se vlerësimi i subjektit është mbështetur në parashikimet e ligjit nr. 96/2016, nenit E të Aneksit të Kushtetutës, dhe orientimet e Kolegjit në vendimin nr. 21, datë 13.09.2019, për subjektin e rivlerësimit G. M.

28.5. Subjekti është vlerësuar “i papërshtatshëm” profesionalisht, si rezultat i dështimit për të provuar se ka treguar aftësi të mira profesionale dhe organizative sipas përcaktimit të neneve 73, 74 të ligjit nr. 96/2016, dhe se ka treguar mungesë etike dhe angazhimi ndaj provueshmërisë së vlerave profesionale, sipas parashikimit të nenit 75 të ligjit nr. 96/2016. Mungesa e bashkëpunimit me Komisionin në procesin e rivlerësimit të aftësive profesionale, nuk ka qenë faktori i shkarkimit për këtë kriter, por në vlerësimin tërësor të procedurave, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, kjo sjellje dhe mungesë bashkëpunimi është mbajtur në konsideratë gjatë procesit të vendimmarrjes, në favor të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, në përputhje me përcaktimet e nenit 48 të ligjit nr. 84/2016.

B.4. Analiza e shkaqeve të ankimit që lidhen me cenimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë

29. Komisioni, në vlerësimin tërësor të rrethanave, sipas parashikimit të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2014, krijoi bindjen se, me veprimet dhe mosveprimet e tij, subjekti ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, sipas parashikimit të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

29.1. Sipas subjektit, (a) cenimi i besimit të publikut përbën shkak shkarkimi bazuar vetëm në vlerësimin tërësor të të tria kriterëve të rivlerësimit, në mënyrë kumulative dhe jo alternative, sipas përcaktimit të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016; (b) Komisioni ka bërë interpretim të gabuar të

Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, pasi mosdhënien e shpjegimeve prej subjektit, e ka vlerësuar si sjellje që ka penguar procesin e vlerësimit; (c) Konkluzioni për cenimin e besimit vjen në kundërshtim me jurisprudencën e Kolegjit, sipas të cilës, cenimi i besimit të publikut konsiderohet shkak shkarkimi vetëm për shkelje ligjore të cilat nuk përbëjnë shkak për aplikimin e rasteve të tjera të shkarkimit, të parashikuara nga pikat 1, 2, 3 dhe 4, të nenit 61 të këtij ligji.

29.2. Në përgjigje të këtij grupi pretendimesh, trupi gjykues i Kolegjit, në analizë të sa referuar më sipër në kriterin e vlerësimit të pasurisë nga Komisioni dhe në vlerësimin tërësor, vëren se konkluzioni i Komisionit, se sjellja e subjektit të rivlerësimit gjatë procesit cenon besimin e publikut tek drejtësia, është i bazuar. Nën dritën e nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, subjekti është treguar jo bashkëpunues në procesin e hetimit administrativ, me kontradikta e kundërthënie të përsëritura, sikurse evidentuar tek vlerësimi i kriterit të pasurisë, duke mbajtur një linjë përgjigjesh e sjelljesh që duken si përpjekje për të mjegulluar faktet e çuar në lajthim organin administrativ (Komisionin) apo duke dhënë shpjegime mbi bazën e paaftësisë së përkohshme në punë të vitit 2020, për veprime të cilat i përkasin viteve përpara këtij harku kohor. Parë në këtë kontekst dhe nën dritën e perceptimit të publikut, mënyra sesi subjekti ka zgjedhur të ndërveprojë me Komisionin, në një vlerësim tërësor, cenon besimin e publikut tek ai si funksionar i drejtësisë, nëpërmjet veprimeve dhe mosveprimeve që pasqyrojnë zgjedhje të vetë subjektit, të ndërmarra në funksion të mungesës së qartësisë apo manipulimit të organeve të rivlerësimit. Për rrjedhojë, këto konstatime u bënë pjesë e vlerësimit të kryer nga trupi gjykues i Kolegjit për vlerësimin tërësor të çështjes, sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, dhe u gjendën brenda parashikimeve të nenit 61, pika 5 të po këtij ligji.

29.3. Në jurisprudencën e tij, Kolegji ka mbajtur qëndrimin se sjellja e subjektit duhet të jetë pjesë e vlerësimit tërësor të procedurave, sipas parashikimit të nenit 4, paragrafi 2 i ligjit nr. 84/2016.⁸³ Nëse në përfundim të këtij vlerësimi, arrihet në konkluzionin se sjellja e subjektit është e tillë që cenon besimin e publikut te magjistrati gjyqtar ose prokuror, edhe vetëm kjo qasje e sjellje e subjektit ndaj procesit të rivlerësimit, do të përmbushte një nga kushtet e parashikuara për shkarkim nga detyra, atë të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

30. Bazuar në konkluzionet e mësipërme, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit Erind Reovica, *nuk arrin* nivel të besueshëm në vlerësimin e kriterit të pasurisë, rezulton “i papërshtatshëm” në vlerësimin profesional dhe në vlerësimin tërësor *ka cenuar* besimin e publikut, nën dritën e përcaktimeve të neneve D dhe E të Aneksit të Kushtetutës, dhe pikave 3, 4 dhe 5 të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Për rrjedhojë, vendimi nr. 508, datë 10.02.2022, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, është i bazuar në fakte e në ligj, dhe duhet të lihet në fuqi.

⁸³ Shih vendimin nr. 9, datë 26.06.2020, pika 17.12.

PËR KËTO ARSYE,

trupit gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 508, datë 10.02.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Erind Reovica.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 18.03.2025, në Tiranë.

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

RELATORE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

KRYESUES

Sokol ÇOMO

nënshkrimi